

Rritja e transparencës nëpërmjet promovimit të rolit të Auditorit të Brendshëm në zinxhirin e llogaridhënies

Financuar nga:
The Balkan Trust for Democracy.

B | T | D The Balkan Trust for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

Deklaratë mohimi:
Këndvështrimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të The Balkan Trust for Democracy. Instituti KAF merr përsipër përgjegjësinë e plotë për përmbajtjen e këtij raporti.

Përgatitur nga:
Mejreme Xh. Ymeri
Ekipi i projektit:
Mimoza Qamili Krasniqi
Admir Shala dhe Bujar Krasniqi

Originali është shkruar në gjuhën angleze

Botuar nga:
INSTITUTI KAF
Bedri Pejani nr. 1
Prishtinë, 10 000, Republika e Kosovës
Tel: +381 (0) 38 220 608
www.ikaf.org



Instituti për
Kontabilitet
Auditim
Financa

E drejta autoriale ©2016 nga INSTITUTI KAF. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem riprodhimi, apo të transmetohet, në asnjë formë apo nga asnjë mjet, qoftë elektronik, apo mekanik, fotokopjues, regjistruar apo tjetër, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi.

Përmbajtja:

Akronimet dhe shkurtesat	4
Përmbledhja Ekzekutive.....	5
1. Hyrje.....	6
2. Fazat e projektit.....	8
2.1 Transparenca	10
2.2 Llogaridhënia	12
2.2.1 Zinxhiri i llogaridhënies	13
2.2.2 Kuvendi Komunal.....	15
2.2.3 Komiteti i Auditimit	17
2.2.4 Roli i Auditorit të Brendshëm	18
2.2.5 Roli i Auditorit të Brendshëm në shtetet fqinje (Shqipëri dhe Maqedoni)	20
2.2.6 Çështjet e ndërlidhura.....	22
3. Hulumtimi në terren.....	24
3.1 Përmbledhje ekzekutive	24
3.2 Objektivat e hulumtimit në teren.....	25
3.3 Metodologjia	25
3.3.1 Grupet e synuara:	25
3.3.2 Instrumentet e përdorura për hulumtim:.....	26
3.3.3 Zgjedhja e mostrës për realizimin e hulumtimit në teren	26
3.4 Rezultatet e Hulumtimit.....	27
Transparenca në Komuna	46

4. Përmbledhja e përfundimeve të gjeturave dhe rekomandimeve	49
5. Drejtimet e ardhshme strategjike.....	55
Aneks: Lista e Komunave të përfshira në hulumtim	62
Burimet e përdorura:	63

Akronimet dhe shkurtesat

Akronimet

UA

ZKA

MFK

KPF

SSP

KA

OB

ISA

COSO

AVP

Domethënia

Udhëzim Administrativ

Zyra Kombëtare e Auditimit

Ministria e Financave

Komiteti për politikë dhe financa

Subjektet e Sektorit Publik

Komiteti i Auditimit

Organizatë Buxhetore

Institucionet Supreme të Auditimit

Korniza e integruar për kontrollin e brendshëm

Arsimimi i vazhdueshëm profesional

Përmbledhja Ekzekutive

Llogaridhënia dhe ndershmëria, përkufizojnë **transparencën e qeverisë**. Qeveritë ekzistojnë që të iu shërbejnë njerëzve dhe në një shoqëri të lirë, transparenca është obligim i qeverisë që të ndajë informatat me qytetarët. Informatat se si zyrtarët realizojnë obligimet dhe detyrat publike si dhe shpenzojnë paratë e taksapaguesve duhet të jenë të gatshme dhe lehtë të kuptueshme.

Qeveritë në nivel qendror dhe lokal derisa adaptohen dhe i përgjigjen në mënyrë rapide trendeve në ndryshim e sipërm ekonomike, sociale, politike dhe teknologjike, duhet të përpiqen që të rrisin nivelin e dhënies së informatave dhe të gjejnë mënyrat se si do të i komunikojmë informatat relevante më mirë para publikut.

Prandaj, objektivë kryesorë e këtij raporti është përshkrimi i gjendjes së tanishme të transparencës dhe rolit të auditorit të brendshëm në zinxhirin e llogaridhënies, duke u fokusuar në nivelin komunal, e që përcillet me rekomandimet për të gjeturat dhe drejtimit e sygjera strategjike për të ardhmen, që të përmirësohet gjendja e tanishme. Ofrimi i shërbimeve publike në nivel lokal është i kufizuar për shkak të burimet të pakta dhe njëkohësisht qeveria lokale ekspozohet ndaj mashtrimit, gabimeve, përvetësimeve të gabuara dhe operacioneve joefikase dhe joefektive, duke qenë njëkohësisht nën vëzhgimin e qytetarëve lidhur me pritjet për transparencë. Për secilën njësi të qeverisjes lokale, ekzistojnë rreziqe që synimet dhe objektivat mund të mos arrihen dhe të gjitha përpjekjet e synuara për të identifikuar dhe/ose rekomanduar parandalimin e rreziqeve të tilla, konsiderohen si punë e auditimit të brendshëm, derisa faktikisht kjo duhet të jetë detyrë me prioritet e menaxhmentit operativ dhe atij të lartë. Në këtë dokument do të vihet në pyetje nëse mekanizmat ekzistues që veprojnë në këtë drejtim, janë duke funksionuar dhe nëse jo çfarë mund të përmirësohet duke e marrë parasysh që Kosova, si çdo vend tjetër në tranzicion është duke bërë përpjekje drejt përmirësimit të perceptimi të transparencës së saj. Vlerësimi i tanishëm nga Transparency International e rangon Kosovën në vendin e 103rd prej 168 vendeve të vlerësuara me 33 pikë prej 100, gjë që është përcjellë nga vitet e kaluara.

1. Hyrje

Projekti "Rritja e Transparencës përmes promovimit të rolit të Auditimit të Brendshëm në zinxhirin Llogaridhënës" kishte një fushëveprim shumë të gjerë duke analizuar konceptet kyçe drejt qeverisjes së mirë në sektorin publik, si **transparencën** dhe **llogaridhënien**, përfshirë promovimin e rolit të **auditimit të brendshëm**.

Për të promovuar rolin e Auditorit të Brendshëm, duhet të sigurohemi që në fillim se ekzistojnë parakushtet bazë për funksionimin e tij. Duke filluar me vendosjen organizative, numrin e mjaftueshëm të personelit në Njësinë e Auditimit të Brendshëm, cilësinë e punës së AB, komunikim të mirë mes Auditorit të Brendshëm dhe Kryesuesit të subjektit të qeverisjes vendore, themelimit të Komiteteve të Auditimit dhe në fund, ekzistimit të sistemit të mirë për përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve. Duke bërë një analizim më të thellë të gjendjes së tanishme dhe zbatimit praktik të kornizës ligjore për auditimin e brendshëm dhe mënyrat se si transparenca komunale mund të rritet përmes promovimit të këtij roli.

Derisa u realizua një hulumtim i tërësishëm gjatë rishikimit të dokumentacionit dhe hulumtimit në terren, ne kemi përcaktuar që edhe pse ekzistojnë disa parametra të caktuar për një funksionim mirë të zhvilluar të auditimit të brendshëm, ende ka hapësirë për përmirësime drejt një të kuptuari më të mirë të rolit të vërtet të auditimit të brendshëm në organizatat buxhetore dhe më shumë njohje të këtij roli nga ana e menaxhmentit të niveleve të tjera në një subjekt të qeverisë lokale dhe në anën tjetër për auditorin e brendshëm që të punoj më shumë për të përkrahur Kryetarin e Komunës në procesin e llogaridhënies nëpërmes këshillimit për përmirësimin e vazhdueshëm të kontroleve të brendshme të vendosura nga menaxhmenti i lartë.

Auditimi i brendshëm ngërthen në vete edhe një element tjetër që përbën të ashtuquajturin trekëndëshin e auditimit të brendshëm dhe ai është Komiteti i Auditimit. Ky themelohet për të përkrahur punën e auditorit dhe njëkohësisht të këshilloj dhe përkujdeset që rekomandimet e auditimit

të brendshëm dhe atij të jashtëm, zbatohen nga menaxhmenti gjë që deri më tani nuk ka treguar ndonjë përparim në veçanti në fushën e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm.

Prandaj, ne kemi marrë në konsideratë që të eksplorojmë mekanizmat e tjerë ekzistues që sigurojnë që në Komuna zbatohet një sistem i mirëfilltë financiar dhe që personat që bartin përgjegjësitë për ekzekutimin e buxhetit e realizojnë këtë përgjegjësi sipas kornizës ligjore në fuqi dhe në pajtim me praktikat më të mira ndërkombëtare, derisa e shtyjnë Kryetarin e Komunës të jap llogari, nëpërmes Kuvendit Komunal. Ky mekanizëm është Komiteti Komunal për Politikë dhe Financa. Duke e konsideruar që përfshirja më e madhe e këtij Komiteti do të sillte edhe “një palë sy” në sistemin e auditimit të brendshëm, zgjerimi i trekëndëshit të deritanishëm jo shumë efektiv do të ishte më efektiv në formatin e ri. Kjo do të ishte edhe një mundësi për të shtuar llogaridhënien e që do të shtonte transparencën rreth shpenzimit të parasë publike dhe dhënien e shërbimeve duke siguruar vlerën më të mirë për paranë e dhënë.

Në çështjen e transparencës, Ministria e Administratës për Qeverisjen Lokale ka nxjerrë një Udhëzim Administrativ vitin e kaluar për Transparencën në Komuna 01/20151, sipas të cilit nga komunat kërkohet që të nxjerrin Planin e Veprimit për zbatimin e këtij udhëzimi. Vetë udhëzimi do të duhej që të plotësohet/ndryshohet për të përfshirë së paku procesin edhe zbatimin e rekomandimeve të auditorit të jashtëm. Pasi që raportet e auditimit të jashtëm janë në dispozicion për publikun, atëherë komunat duhet të nxjerrin një plan veprimi me afat kohorë për zbatimin e rekomandimeve të dakorduara dhe kjo do të tregonte përpjekjet e komunës drejt një qeverisje më të mirë duke përmirësuar transparencën dhe mirëmbajtur profesionalizimin.

Nga hulumtimi i kryer në terren i kryer në 18 komunat e përzgjedhura, ne kemi gjetur që Zyrtarët në krye të zinxhirit të llogaridhënies nuk e çmojnë shumë rolin e auditimit të brendshëm që të i përkrahë ata në llogaridhënie. Njëkohësisht, nuk kemi gjetur asnjë qasje të institucionalizuar se si komunat do të jenë më transparente. Ka pasur disa përpjekje të pasuksesshme dhe të paqëndrueshme lidhur me këtë.

¹Shih <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11403>

2. Fazat e projektit

Me qëllim të arritjes së objektivave të Projektit, ekipi i projektit ka ndarë punën në dy faza kryesore:

1. Rishikimi i dokumentacionit, përfshirë:

- a. Standardet dhe udhëzimet: Kornizën Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale për Auditimin e brendshëm²;
- b. Kornizën ligjore që rregullon funksionin e auditimit të brendshëm në Republikën e Kosovës, ligjet dhe aktet nën-ligjore;
- c. Ligje, rregullore dhe strategji që rregullojnë fushën e transparencës dhe llogaridhënies;
- d. Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit në Kosovës për katër vite të njëpasnjëshme, për të gjitha komunat e Kosovës;
- e. Raportet nga shoqëria civile që veprojnë në fushën e transparencës dhe vëzhgojnë sektorin publik;
- f. Raporte nga mekanizma dhe institucione ndërkombëtare;
- g. Hulumtimin dhe testimin e raportimit online të korrupsionit në ueb faqet e komunave.

2. Hulumtimi në terren, përbëhet nga:

- a. Pyetësi i parapërgatitur, që përmban kërkesat bazike për ekzistimin e auditimit të brendshëm si funksion në administratën publike;
 - b. Takimet me akterët relevant në identifikimin dhe sygjerimin e platformës së komunikimit;
 - c. Vizitat studimore në vendet rajonale ku auditimi i brendshëm është zhvilluar gati njëherësh me Kosovën;
3. Hartimi i raportit bazuar në të gjeturat nga rishikimi i dokumentacionit dhe hulumtimit në terren;
 4. Promovimi i të gjeturave dhe rezultateve;

² Versionet e fundit të publikuara: <https://na.theiia.org/standards-guidance/Pages/Standards-and-Guidance-IPPF.aspx>

5. Monitorimi

Përgjatë këtij dokumenti, ne shkurtimisht do të përmbledhim konceptet kyçe të përmendura më lartë dhe se si ato interpretohen në aktivitetet komunale, si dhe do të sygjerojmë se çfarë do të mund të sillte transparencë më të mirë të komunave, gjë që do të reduktonte nivelet e raportuara të korrupsionit, duke përdorur një instrument shumë të vlefshëm të menaxhimit, auditimin e brendshëm.

2.1 Transparenca

Në parim, zyrtarët publik, shërbyesit civil, menaxherët dhe drejtorët e kompanive dhe organizatave si dhe administruesit e bordit e kanë për detyrë që të veprojnë dukshëm, parashikueshëm dhe kuptueshëm për të promovuar pjesëmarrjen dhe llogaridhënien dhe për t'i lejuar palëve të treta që të kuptojnë lehtë se çfarë veprimesh janë ndërmarrë.

Kjo në praktikë, nënkupton që Kryetari/ja i/e komunës, menaxhmenti i lartë, auditorët e brendshëm duhet të promovojnë qeverisjen e mirë dhe të punojnë drejt parimeve të saja, duke ju mundësuar palëve të treta si popullit, që të kuptojnë se çfarë po ndodhë në rrethinën e tyre. Jo të gjithë do të kenë mundësinë për të absorbuar informatat e dhëna, por ka palë të tjera të interesuara që do të mund të ndihmojnë në këtë proces si Zyra Kombëtare e Auditimit, një shoqëri civile aktive dhe media: të shkruara, elektronikë dhe online.

Vënia e informative në dispozicion nuk është e mjaftueshme për arritjen e transparencës. Numri i madh i informative të papërpunuara, mund më shumë të rritin paqartësisë se sa transparencën.

Po ashtu, jo të gjitha informata janë për t'u shpalosur para publikut.

Kushtetuta e Kosovës, në nenin 41, thotë që “çdo kush ka të drejtë të kërkoj një dokument dhe institucionet obligohen që një dokument të tillë ta vënë në dispozicion për publikun”³. Në bazë të kësaj, është dekretuar Ligji për qasje në dokumentet publike Nr. 03-L-215 dhe së fundi Udhëzimi Administrativ për Transparencën Komunale. Megjithatë, kjo nuk e bënë në praktikë transparente as qeverinë qendrore e as atë lokale.

Është me rëndësi që qytetarët të dinë që ata kanë të drejtë dhe

Transparenca është karakteristikë e qeverive, kompanive, organizatave dhe individëve që janë të hapur në shpalosje të informatave, rregullave, planeve, proceseve dhe veprimeve.

³ Kushtetuta e Kosovës, Faqe 13, neni 41


secili duhet të informohet. Informata duhet të menaxhohet dhe publikohet ashtu që të jetë:

- **Relevante dhe qasshme:** informata duhet të prezantohet në gjuhë dhe format të thjeshtë dhe të kuptueshëm. Ajo duhet të jetën në dispozicion në mënyra që janë adekuate për audiencë të ndryshme.
- **Me kohë dhe e saktë:** informata duhet të jetë në dispozicion në kohë të mjaftueshme për të mundësuar analizimin, vlerësimin dhe angazhimin nga ana e të gjitha palëve të interesuara. Kjo do të thotë që informata duhet të ofrohet gjatë fazave të planifikimit si dhe pas zbatimit të politikave dhe programeve. Ajo duhet të menaxhohet për të qenë e freskët, e saktë dhe komplete.

PSE KA RËNDËSI ?

Transparenca më e madhe është e barabartë me nivele më të ulëta të korrupsionit. Nëse ekziston nivel i ulët i transparencës në Organizatën Buxhetore, ky është një simptomë e fuqishme që ka gjasa më të mëdha për korrupsion. Përveç kësaj, Organizatat buxhetore në përgjithësi veprojnë nga paratë e tatim-paguesve dhe ato duhet të konvertohen në jetesë më të mirë të qytetarëve, po të ketë transparencë, lehtë mund të kuptohet nga njerëzit se a janë duke u shpenzuar mirë paratë e tyre.

Indeksi i perceptimit të korrupsionit⁴



Institucionet financiare duhet të zotohen që të raportojnë çdo vit për masat të cilat i kanë adaptuar në përforcimin e menaxhimit të rrezikut, në veçanti në raport me mito dhe korrupsionin tek bordet dhe menaxherët e

⁴ **Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit** renditet e vendet/territoret bazuar në atë se sa perceptohet të jetë i korruptuar sektori publik i një vendi. Ky është një indeks i përbërë, duke u bazuar në të dhënat e lidhura me korrupsionin nga sondazhe ekspertësh dhe biznesesh të kryera nga një shumëllojshmëri të institucioneve të pavarura dhe të besueshme.

*lartë*⁵. Për Kosovën, indeksi i perceptimit të korrupsionit nuk ka treguar asnjë sukses drejt përmirësimit. Kosova është ranguar e 103 prej 168 me një rezultat 33/100⁶, duke pasur pikët më të pakta krahasuar me vendet në rajon⁷.

Në anën tjetër, duhet të ekzistoj një listë me numrin minimal të kriterëve për të përcaktuar një Organizatë buxhetore, pra Komunë është transparente apo jo. Gjatë hulumtimit tonë të dokumentacionit dhe në terren, ne kemi hasur Udhëzimin Administrativ për Transparencën Komunalë që përmban një numër të kriterëve që organizatat buxhetore të nivelit lokal të jenë transparente. Por përkundër faktit që ky UA është miratuar në vitin 2015, janë ndërmarr vetëm disa hapa për të zbatuar atë. Në fund të këtij raporti, ne kemi përfshirë kriteret e kërkuara me këtë UA duke i kombinuar me disa kriterë tjerë të përdorura si praktikë e mirë dhe kemi hartuar Pyetësorin e Vetë-vlerësimit për Transparencë që duhet të monitorohet nga Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal çdo tre muaj për të matur transparencën e Komunave.

2.2 LLOGARIDHËNIA

Koncepti i llogaridhënies ka një traditë të gjatë edhe në shkenca politike si dhe në kontabilitetin financiar. Si koncept në etikë dhe qeverisja me disa kuptime, llogaridhënia shpesh përdoret si sinonim i koncepteve të përgjegjësisë, përgjegjshmërisë, detyrimit dhe termet e tjera të shoqëruar me pritjet për dhënie të llogarisë.

Si aspekt i qeverisjes, ka qenë temë e diskutimit lidhur me problemet në sektorin publik, kompanitë jo-profitabile dhe private. Llogaridhënia mund të jetë në formë të llogaridhënies sociale, financiare, politike, administrative, etike dhe ligjore.

⁵ <http://www.transparency.org/country/#KOS>

⁶ **Pikët** rangojnë nga 0 (shumë i korruptuar) deri në 100 (shumë i pastër).

⁷ <http://www.transparency.org/country/#KOS>

Në përgjithësi **llogaridhënia** nënkupton të siguarit që zyrtarët në sektorin publik, privat apo organizatat vullnetare janë të përgjegjshëm për veprimet e tyre. Llogaridhënia është një **marrëdhënie e institucionalizuar** në mes të palëve të ndryshme. Njëra pjesë e njerëzve/organizatave japin llogari dhe pjesa tjetër merr llogari.

Llogaridhënia mund të kategorizohet sa i përket mekanizmave horizontal, vertikal dhe diagonal, megjithatë kushti është që sukcesi zakonisht arrihet jo vetëm me përdorimin e njëres qasje, por me bashkëveprimin e tyre.

- **Llogaridhënia horizontale** përbëhet nga marrëdhënia formale në kuadër të vetë shtetit, ku një akter i shteti ka autoritet formal për kërkuar shpjegime ose vendosur penalti në një tjetër.
- **Format e llogaridhënies vertikale** janë ato në të cilat qytetarët dhe shoqatat e tyre kanë rol të drejt për drejtë në kërkimin e llogarisë nga ata që janë në pushtet.
- **Llogaridhënia diagonal** funksionon në domenin në mes të dimensioneve vertikale dhe horizontale. I referohet fenomenit të angazhimit të drejt për drejt të qytetarëve me institucionet e llogaridhënies horizontale kur provokohet mbikëqyrja më e mirë e veprimeve të shtetit.

Llogaridhënia – koncepti që individët, agjencionet dhe organizatat (publike, private dhe shoqëria civile) japin llogari duke raportuar për ushtrimin adekuat e autoritetit dhe aktiviteteve të tyre, përfshirë edhe përgjegjësit për para të ose pronat e besuara.

2.2.1 Zinxhiri i llogaridhënies

Qeveria e Republikës së Kosovës, ka vendosur dhe vënë në zbatim llogaridhënien sipas ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive L-029 dhe nëpërmjet të Rregullit Financiar të Thesarit 01/2010.

Sipas Rregullit Financiar të Thesarit 01/2010, llogaridhënia për administratën lokale, është e koncentruar në Kryetarin e Komunës i cili është i zgjedhur nga populli dhe për këtë arsye drejt për së drejti i jep llogari popullit dhe Kuvendit Komunal. Zyrtari Kryesor Financiar, Drejtorët dhe Auditorët e brendshëm i japin llogari Kryetarit të Komunës.

Sipas kësaj rregulle, nën paragrafin 1.2.2 ceket që “Për dallim nga organizatat qendrore buxhetore, ku përgjegjësia për administrimin dhe funksionimin e tyre mbetet me ZKA-në, Kryetari i Komunës udhëheq edhe qeverisjen komunale dhe administrimin/funksionimin dhe është përgjegjës para njerëzve për veprimet e të dyjave. Si rrjedhojë, të gjitha referimet në përgjegjësitë dhe llogaridhëniet e ZKA-së në këtë Rregull të Thesarit dhe Doracakun e Procedurave të MFK-së duhet të zbatohen nga ZKA-të e organizatave buxhetore qendrore dhe Kryetarët e Komunave.”⁸

Me qëllim të qartësimit të të gjitha aspekteve për të cilat kryetarët e komunave japinë llogari, ne do të elaborojmë vetëm dy lloje të llogaridhënies në bazë të rregullës së Thesarit për llogaridhënie në Kosovë.

- **Llogaridhënia politike**

Derisa Kryetari i Komunës do të bartë këtë përgjegjësi krahas menaxhimit të i njësisë lokale – komunës, do të duhet që këto dy role të ndahen qartë.

Llogaridhënia politike është llogaridhënia e shërbyesve civil dhe politikanëve qeveritar ndaj publikut dhe organeve legislative si parlamenti ose kuvendi komunal. Votuesit nuk kanë ndonjë mënyrë të drejt për drejt për të kërkuar llogari nga përfaqësuesit e zgjedhur gjatë kohës për të cilën janë zgjedhur. E vetmja mënyrë që mund të bëhet kjo është matja e outputit dhe rezultatit të objektivave të vendosura në planin e kandidatit fitues që mund të përkthehet në planin strategjik për Komunën ose të jetë pjesë e planit tashmë të përcaktuar strategjik.

Në këtë pikë llogaridhënia politike transformohet në llogaridhënie Menaxheriale që është më lehtë të përcillet në krahasim me llogaridhënien politike.

- **Llogaridhënia menaxheriale/administrative**

Në kuadër të sektorit publik, llogaridhënia është procesi ku subjektet e sektorit publik dhe individët në kuadër të tyre, janë përgjegjës për vendimet dhe veprimet e tyre, përfshirë edhe kujdestarinë ndaj fondeve publike dhe të gjitha aspektet e performancës, si dhe i nënshtrohen vëzhgimit nga jashtë. Idea

⁸ Rregulli Financiar i Thesarit 01/2010

është që pritet për llogaridhënie, standardet dhe parimet për t'u kujdesur për veprimet, proceset, outputet dhe rezultatet të komunikohen duke qenë fleksibil në qasjet e përdorura për promovimin e kësaj llogaridhënie.

Rregullat dhe normat e brendshme si dhe disa organe të pavarura, janë mekanizmat me anë të së cilëve mund të kërkohet llogari nga shërbyesit civil në kuadër të administratës së qeverisë. Individët e ngarkuar me dhënie të llogarisë duhet të shpjegojnë nëse dhe pse rezultati dallon nga ai që është synuar dhe çfarë veprimi është ndërmarr për të përmirësuar këtë çështje.

Por, si mundet populli të kërkojë llogari? Sa i përket kësaj, ne kemi rishikuar rolin dhe përgjegjësit e palëve të ndryshme të interesuara drejt për së drejti ose në mënyrë indirekte në zinxhirin e llogaridhënies.

2.2.2 Kuvendi Komunal

Sipas Ligjit për Vet-qeverisje⁹, Komuna qeveriset nga Kryetari i Komunës dhe Kuvendi Komunal. Kuvendi Komunal ka të drejtë të kërkojë llogari nga Kryetari i komunës për mbarëvajtjen e gjithmbarshëm të punëve në Komunë.

Kuvendi Komunal ka dy Komitetet të përhershme:

1. Komiteti për Politikë dhe Financa; dhe
2. Komiteti për Komunitet.

Kuvendi Komunal ka të drejtë që të themelojë edhe komitet të tjera sipas specifikave të Komunës, por në këtë raport, do të fokusohemi në rolin e Komitetit për Politikë dhe Financa pasi që e konsiderojmë që ky është çelësi drejt promovimit të rolit të Auditorit të Brendshëm në komunë, derisa e shtynë Kryetarin dhe personelin e ndërvarur të tij, të njohur si Bordi i Drejtorëve që të jap llogari për veprimet e

⁹ Shih Ligjin për vetë-qeverisjen lokale

ndërrmarra lidhur me përmirësimet e nevojshme në proceset dhe sistemet komunale, bazuar në të gjeturat e auditorit të brendshëm dhe atij të jashtëm, nëpërmes të Kuvendit Komunal.

Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa në numra ndryshon nga një komunë në tjetrën dhe e njëjta vlen edhe për përfaqësimin gjinor si dhe politik.

Në 18 komuna ku është realizuar hulumtimi, KPF numëron nga 7-16 anëtarë dhe roli i tij është të rishikojë:

1. Të gjitha politikat
2. **Dokumentet fiskale dhe financiare;**
3. Planet, iniciativat duke përfshirë **dokumentin e planifikimit strategjik;**
4. KASh;
5. Planin vjetor të prokurimit;
6. Rregulloren vjetor për taksa, tarifa dhe ngarkesa;
7. **Panin vjetor të punës së auditimit të brendshëm;**
8. Planin vjetor të buxhetit, afat-mesëm dhe çfarëdo ndryshimi në buxhet gjatë vitit fiskal, dhe
9. **Pranon raporte nga Kryetari i komunës dhe i dorëzon rekomandimet tek kuvendi komunal**

Nga aspekti i këtij raporti, roli i këtij komiteti konsiderohet si shumë i rëndësishme në adresimin e rekomandimeve të pa trajtuara të auditimit të brendshëm dhe atij të jashtëm. Ky komitet mund të asistohet nga Komiteti i Auditimit që përbëhet nga profesionist të fushës, që i kuptojnë raportet e auditimit të jashtëm dhe të brendshëm pasi që jo të gjithë anëtarët e këtij komiteti kanë njohuri financiare.

2.2.3 Komiteti i Auditimit

Komiteti i auditimit është një organ këshillues dhe këshillëdhënës. Roli i këtij komiteti është përcaktuar në Ligjin për Auditimin e Brendshëm 2010/01 dhe është elaboruar më hollësishtëm në Udhëzimin Administrativ për themelimin e komiteteve të auditimit Nr. 11/2010. Nga 18 komunat në këtë hulumtim, vetëm dy nuk kishin themeluar KA.

Roli Komiteteve të auditimit është që të:

- 1.1 Japin këshilla për KBFP në të gjitha fushat e përgjegjësisë së menaxhmentit të lartë;
- 1.2 Sigurojnë që menaxhmenti i SSP kryen aktivitetet e tija në pajtueshmëri me të gjitha obligimet e zbatueshme ligjore;
- 1.3 Rishikon dhe miraton por nuk qeverisë me strategjinë dhe planet vjetore të Njesisë së Auditimit të Brendshëm;
- 1.4 Rishikon raportet e përmbledhura të auditimit të brendshëm, të gjeturat dhe rekomandimet e paraqitura dhe kërkon siguri që ato janë adresuar si duhet nga menaxhmenti i SSP;
- 1.5 Rishikon pasqyrat financiare dhe opinionet e raportet e auditimit të jashtëm;
- 1.6 Rishikon reagimin e menaxhmentit për çështjet që janë paraqitur nga auditimi i jashtëm;
- 1.7 Siguron marrëdhënie efektive në mes të menaxhmentit, Njesisë së Auditimit të brendshëm dhe auditorit të jashtëm:
- 1.8 Mbron pavarësinë funksionale të njesisë së auditimit të brendshëm
- 1.9 Vlerëson përshtatshmërinë e burimeve të auditimit të brendshëm
- 1.10 Siguron që mashtrimi potencial ose korrupsioni i dyshuar, është identifikuar nga raportet e auditimit të brendshëm ose ndryshe është vënë në dijeni të Komitetit të Auditimit, i raportohet autoriteteve kompetente.
- 1.11 Këshillon për çështjet që ndërlidhen me rreziqet e identifikuara dhe sistemin e KBFP-së
- 1.12 Mbanë të dhëna për të gjitha takimet së bashku me raportet e ofruara nga funksioni i auditimit të brendshëm dhe të gjitha dëshmitë e shkruara për të gjitha çështjet dhe dëshmitë që ndërlidhen me këto raporte si dhe veprimet e ndërmarra nga Komiteti i auditimit.

1.13 Ofron qasje të plotë dhe të papenguar në të gjitha të dhënat pse raportet e nxjerra ose të mbajtura nga Komiteti i auditimit, me kërkesë të auditorit të përgjithshëm ose ndonjë autoritet tjetër publik që ka funksion hetues ose kontrolli.

1.14 Përgatit dhe nxjerr Statutin e Komitetit të Auditimit, i cili do të nënshkruhet nga anëtarët e Komitetit të Auditimit dhe menaxhmenti i organizatës në fjalë. Statuti do të mbuloj temat në vijim: përbërjen e Komitetit të auditimit, anëtarësimin, pjesëmarrjen në takime, frekuencën e takimeve, autoritetin, detyrat, procedurat e raportimit dhe pagesës, që bëhet bazuar në ligjet dhe udhëzimet në zbatim.

2.2.4 Roli i Auditorit të Brendshëm

Qeverisja dhe transparenca e dobët, konsiderohen që janë shkaqet kryesore të llogaridhënies jo-efektive të qeverisë në sektorin publik dhe ndikojnë të gjithë tatimpaguesit dhe qytetarët.

Duke qenë që qeveritë, po përballen me deficit dhe borxhe gjithnjë në rritje, mungesa e një llogaridhënie efektive të qeverisë, është duke u bërë sfidë kryesore për shërbimet që ata mund të i ofrojnë me burimet në dispozicion.

Në një mjedis të tillë, auditimi i brendshëm ka mundësi të mëdha për të ndihmuar në përmirësimin e mbikëqyrjes dhe praktikave qeverisëse në sektorin publik. Siç është shpjeguar më lartë, në zinxhirin e llogaridhënies, nuk ka ndonjë rol të drejt për drejt për auditorin e brendshëm. Por në mënyrë indirekte ata mund të ndihmojnë Kryesuesin e OB që jap llogari duke rekomanduar përmirësime në kontrollet e brendshme të organizatës.

Si mund auditori i brendshëm të përmirësoj gjendjen?

Në përkufizimin e IAB thuhet që *“Auditimi i brendshëm është një aktivitet i pavarur, me siguri objektive dhe këshillëdhënës, i dizajnuar për të shtuar vlerë dhe përmirësuar veprimtarinë e organizatës. Ai*

ndihmon organizatën në arritjen e objektivave të saja duke sjell një qasje sistematike, të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe proceseve të qeverisjes.”

Sipas Kornizës Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale për Auditorin e Brendshëm, **Qeverisja** është kombinim i proceseve, strukturave që zbatohen nga bordi me qëllim të informimit, drejtimit, menaxhimit dhe monitorimit të veprimeve të organizatës drejt arritjes së objektivave të saja.¹⁰

Kosova ka themeluar funksionimi e auditimit të brendshëm para gati një dekade, për ta bërë të obligueshme për zbatim nga të gjitha organizatat buxhetore me Ligjin e parë të Auditimit të Brendshëm, të dekretuar në vitin 2008. Që atëherë është dhënë përkrahje e madhe kryesisht nga Asistenca Teknike e BE-së për të sjellë funksionin e auditimit të brendshëm në rolin e këshilldhënies në vend të inspektimit dhe revizionit.

Ministria e Financave është përkrahur vazhdimisht në trajnimin dhe certifikimin e auditorëve të brendshëm në sektorin publike. Megjithatë, me sa duke fokusimi kryesisht ka qenë në avancimin profesional të auditorëve të brendshëm drejt përmbushjes së Standardeve Ndërkombëtare për Auditimin e brendshëm dhe shumë më pak në arsimimin e menaxhmentit të organizatave buxhetore për të shfrytëzuar auditimin e brendshëm si instrument për përmirësim të qeverisjes, e njëkohësisht për të ju ofruar auditorëve të brendshëm mjetet që mundësojnë performancën e organizatës buxhetore. Thënë kështu, auditimi i brendshëm do të performonte shumë mirë, nëse ekziston një sistem i mirëfilltë për menaxhimin financiar dhe kontrollit, që fillimisht ka për synim rregulla dhe rregullore të qarta, procedura të brendshme të përgjithshme dhe specifike, vlerësim të rrezikut dhe komunikim e informim. Pa këto elemente të vendosura nga Menaxhmenti, atëherë auditimi i brendshëm nuk mund të shtoj vlerë të vërtet organizatës.

Rregullimi i auditimit të brendshëm është i njëjta si në nivel qendror ashtu edhe lokal, **me një dallim të rëndësishëm**. Në nivel qendror auditori i brendshëm rishikon punën e ZKA-së (Sekretarit të

¹⁰ Kroniza e Praktikës Profesionale: Standardet ndërkombëtare për Praktikën Profesionale

Përgjithshëm) dhe i raporton Ministrit dhe në nivel lokal auditori i brendshëm rishikon punën e ZKA-së (Kryetarit të Komunës) dhe i raporton Kryetarit të Komunës.

Kryetari i Komunës sipas ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi Nr. L-029 është i barabartë me ZKA-n në nivelin qendro dhe si i tillë jep llogari (administrative dhe politike) popullit sipas zinxhirit të llogaridhënies të prezantuar në Rregullin Financiar Nr. 01/2010.

Njëkohësisht, në Ligjin për Auditimin e Brendshëm Nr. 128, neni 3.1¹¹ thuhet që auditori i brendshëm duhet të vendoset në nivelin më të lartë të organizatës buxhetore, duke i raportuar drejt për së drejti menaxhmentit të lartë – Kryetarit për të siguruar pavarësi të plotë në funksionimin e tij. Por shqetësimi i ynë, është që edhe pse Njësia e auditimit të brendshëm në përgjithësi në komunat nën hulumtimin tonë, është i pozicionuar në nivelet më të larta të komunës duke i raportuar drejt për së drejti Kryetarit të Komunës dhe është në nivel horizontal me Drejtorët e Departamenteve tjera, kjo nuk jep siguri që ata janë plotësisht të pavarur në kryerjen e punëve të tyre. Arsyeja e theksimit të kësaj çështje, është se ka mospërputhje në mes të raporteve të auditimit të brendshëm dhe jashtëm në fushën e të gjeturave. E njëjta çështje ishte me shqetësim për vendet fqinje që ne i kemi vizituar dhe kjo është diskutuar me palët e tjera të interesuara.

2.2.5 Roli i Auditorit të Brendshëm në shtetet fqinje (Shqipëri dhe Maqedoni)

Gjatë fazës së hulumtimit në terren, ne kemi vizituar pesë institucione në dy vendet fqinje: Shqipëri dhe Maqedoni, përkatësisht Departamentet e KBFP-së dhe institucionet e AS dhe Komunën e Tiranës.

Qëllimi i vizitës ishte që të gjejmë nëse ka modalitet më të mira për të sjell rolin e auditorit të brendshëm në nivel më të mirë. Në të dyja vendet kemi parë shqetësime rreth pavarësisë së auditorit të brendshëm dhe si emërues i përbashkët i të dyja vendeve ishte që auditorët e brendshëm duhet të

¹¹ <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/>

punësohen dhe paguhen nga një institucion si zyra e Kryeministrit ose diçka e ngjashme, si e vetmja alternativë që do të siguronte pavarësinë e tyre.

ISA në Shqipëri i jep mjaftë vlerë punës së auditimit të brendshëm, duke u mbështetur në punën e tyre dhe përkrahur në vazhdimësi, derisa në Maqedoni auditorët e jashtëm nuk mbështetën në punën e auditimit të brendshëm.

ISA e Maqedonisë ka bërë vitin e kaluar një auditimit të sistemit të KBFP-së i cili ka përfshirë 80 shpenzues të buxhetit dhe disa institucione tjera përfshirë edhe departamentin e KBFP-së në Maqedoni. Ky ishte një shembull shumë i mirë që të sygjerohej në vendin tonë.

Institucionet janë audituar për performancën dhe kryesisht për elementet e COSO-së dhe të gjeturat dhe rekomandimet i janë raportuar Kuvendit.

Lidhur me arsimimin e auditorëve të brendshëm dhe AVP, të dyja vendet iu kanë qasur ndryshe trajnimit të auditorëve të brendshëm. Shqipëria aktualisht ka filluar një program të trajnimit të hapur për auditorët e brendshëm që ka shtatë module dhe është shumë më i përmirësuar në krahasim me atë që kishin më parë.

Maqedonia është duke mbajtur programin e trajnimit me asistencë teknike.

Asnjëra nga vendet nuk mbështetet në Komitetet e Auditimit, derisa Maqedonia ka një komitet të auditimit me më shumë se 10 anëtarë të themeluar nga Ministri i Financave, në Shqipëri nuk mendojnë se ata janë të dobishëm pasi që anëtarët e Komitetit të Auditimit përzgjidhen nga kryesuesit e subjekteve.

2.2.6 Çështjet e ndërlidhura

Duke qenë që është njëri prej akterëve që kontribuon në menaxhimin e mirëfilltë financiar në sektorin publik, duke dhënë siguri për përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë së përgjithshme të organizatës buxhetore, Zyra Kombëtare e Auditimit është konsultuar gjatë realizimit të këtij projekti.

Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditimit në të gjitha organizatat buxhetore në Kosovë dhe fokusimi primar i saj është në Pasqyrat Financiare të organizatës buxhetore. Por, pjesë e auditimit është edhe rishikimi i funksionimit të Auditimit të Brendshëm. Çdo vit ka rekomandime që duhet të zbatohen, mirëpo siç është vërejtur nga krahasimi tre-vjeçar rekomandimet e njëjta ose të ngjashme përcillen nga njëri vit në tjetrin me pak përmirësime ose fare. Pasi që roli i Zyrës Kombëtare të Auditimit përfundon me dorëzimin e raporteve tek menaxhmenti i OB-të të audituara, pastaj tek Kuvendi nëpërmjet të Komisionit Parlamentarë për Mbikëqyrjen e Financave Publike e gjithashtu bëhen publike, nuk ka shumë fuqi për të shtyrë gjërat përpara drejt përmirësimit të përgjithshëm të gjendjes. Pavarësisht kësaj, këtë vit, Auditori i përgjithshëm ka nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi me Zyrën e Prokurorit, që aty ku ka shkelje, ata do të i raportojnë Zyrës së Prokurorit si autoritet përfundimtar që do të i trajtoj ato.

Përkundër përparimit në trajnimin e auditorëve të brendshëm krahas standardeve ndërkombëtare, auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit ende nuk mbështeten në punën e Auditorit të brendshëm dhe është diskutuar se cilat janë arsyet kryesore për këtë. Problemet kryesore janë paraqitur më poshtë:

1. **Fushëveprimi.**
2. **Mostrimi**
3. **Dosja e auditimit**
4. **Produktiviteti**

Si pjesë e realizimit të projektit, ishte edhe përfshirja dhe këndvështrimi i Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Në diskutim e sipër me Kryetarin e këtij komisioni, është shpalosur se

janë bërë disa përpaparime për të përmirësuar gjendjen por ka shumë hapësirë për përmirësime në veçanti në nivelin e zbatimit të rekomandimeve nga ana e komunave.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike nuk ka ndonjë mandat tjetër përveç që të rekomandoj bazuar në raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit, gjë që është e varur nga shumica e votave në komision. Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer një punë të shkëlqyeshme mirëpo ekziston një numër i rekomandimeve që i janë dhënë Organizatave Buxhetore për të përmirësuar gjendje, bazuar në të gjeturat, disa prej të cilave paraqesin shkelje të shkaktuara nga ana e organizatave buxhetore të cilat duhet adresuar.

Sa i përket vendosjes së një mekanizmi të institucionalizuar për të përcjellë këtë çështje më tutje, do të duhej një komunikimi i rregullt në mes të Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike kryesisht në periudhën e vitit kur buxheti aprovet për nivelin lokal. Kjo do të ndihmonte që zbatimi i rekomandimeve të shtyhej përpara nga ana e Komunave, duke marrë në konsideratë vendosjen e një zvogëlimi të buxhetit nëpër komunat që neglizhojnë në një mënyrë apo tjetër zbatimin e rekomandimeve për disa vite të një pas njëshme.

3. Hulumtimi në terren

3.1 Përmbledhje ekzekutive

Komunat në Kosovë janë të themeluara në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 për vet-qeverisje lokale. Përkrahë kompetencave tjera të komunave, atyre i janë deleguar po ashtu kompetenca edhe nga niveli qendror. Në bazë të parimeve bazike për financa, komunat në Kosovë kanë buxhetin e tyre për të financuar operacionet e veta që rregullohet me ligjin Nr. 03/ L- 049 për Financat e Pushtetit Lokal.

Administrimi i pushteti lokal për nga natyra është një proces mjaftë kompleks në kuptim të ofrimit të shërbimeve për qytetarët dhe riorganizimin e aktiviteteve të qeverisë në nivel qendror. Në anën tjetër, Buxheti i Komunave përbëhet nga tre lloje buxhetesh, buxheti qendror që mbulon fushën e edukimit dhe shëndetësinë primare si dhe aktivitetet kulturore, të hyrat vetanake që grumbullohen nga lloje të ndryshme të taksave dhe tarifave komunale dhe donacionet. Buxheti i Komunës miratohet nga Kuvendi Komunal dhe ekzekutimi i tij është proces që mbikëqyret po ashtu nga Anëtarët e Kuvendit Komunal.

Nga hulumtimi i dokumentacioneve në dispozicion, ne kemi bërë strukturimin e hulumtimit në teren që si proces ka përfshirë zgjedhjen e një mostre reprezentative të Komunave për të dhënë inputin e tyre në pyetësonin e përgatitur drejtuar Drejtorëve të Njësive të Auditimit dhe Kryetarëve të Komunave.

Hulumtimi në teren është fokusuar në fushat kryesore që kërkohen për funksionimin e Auditimit të brendshëm bazuar në Kornizën Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale lidhur me kërkesat e Auditimit të brendshëm, pjesërisht e adaptuar në kuadër të Sektorit Publik në Kosovë, duke u kombinuar me kërkesat në Ligjin për Auditimin e Brendshëm dhe Udhëzimet Administrative që rregullojnë fushën e Auditimit të Brendshëm, ku theksohen obligimet për Organizatat Buxhetore për themelimin e funksionit të auditimit të brendshëm, dhe pyetja e fundit e pyetësonit lidhet më direkt me transparencën dhe llogaridhënien e Komunave.

Një gjë që duhet të theksohet është që Kryetarët e Komunave i janë përgjigjur shumë mirë qëllimit të projektit edhe pse hulumtimi në teren u realizua në periudhën Korrik/Gusht, ku përjashtimisht disave shumica prej tyre janë të vetëdijshëm dhe çmojnë rolin e Njësive të Auditimit të Brendshëm në

organizatën e tyre. Në anën tjetër nuk ka pasur ndonjë ankesë të theksuar nga ana e Drejtorëve të Njësive të Auditimit lidhur me pavarësinë funksionale. Kjo tregon që ka një interes progresiv në drejtim të marrjes së përgjegjësisë për të qenë llogaridhënës por në të njëjtën kohë mbetet për t'u dëshiruar aspekti i rritjes së vetëdijes lidhur me transparencën e komunave, për të kuptuar që funksionet dhe buxheti i komunës i takon qytetarëve dhe kontributi duhet të jepet pikërisht aty.

3.2 Objektivat e hulumtimit në teren

Objektivi i hulumtimit në teren ka qenë që të bëhet një vështrim më i thellë i funksionit të auditimit të brendshëm nga perspektiva e kryesuesit të zinxhirit llogaridhënës në rastin tonë Kryetari i Komunës, si dhe nga perspektiva e auditorëve të brendshëm, gjithmonë bazuar në rregullat që e përcaktojnë këtë funksion.

Në pjesën e parë të pyetjeve, qëllimi ynë ka qenë që të vlerësojmë vendosjen e Auditimit të Brendshëm në Strukturën organizative. Pjesa e dytë e pyetjeve trajton Menaxhimin e Auditimit të brendshëm, ndërsa pjesa e tretë shqyrton ekzekutimin e angazhimit të auditimit të brendshëm, në pjesën e katërt matet impakti i aktivitetit të auditimit dhe për të pasur një konsolidim të plotë të funksionit të auditimit të brendshëm, në pjesën e pestë dhe të fundit të pyetësorit elaborohet se si gjitha elementet e mësipërme i kontribuojnë transparencës nëpër komuna.

3.3 Metodologjia

Metodologjia e përdorur në hulumtim është përdorimi i pyetësorëve ku inputi është marrë nëpërmjet të intervistave. Dizajnimi i pyetjeve është bërë në mënyrë të kombinuar në mes të pyetjeve të mbyllura në shumicën e rasteve dhe pyetjeve me alternativa në më pak raste.

3.3.1 Grupet e synuara:

Ky hulumtim është fokusuar në dy grupe e synuara kryesore:

1. Drejtorët e Njësive të Auditimit; dhe
2. Kryetarët e Komunave të përzgjedhura;

3.3.2 Instrumentet e përdorura për hulumtim:

1. Dy pyetësorë të paracaktuar:
 - a. Pyetësorë për Drejtorët e Njësive të auditimit të brendshëm; dhe
 - b. Pyetësorë për Kryetarët e Komunave;
2. Takime me akterët kryesorë në fushën e Llogaridhënies dhe Transparencës
 - a. Komiteti për mbikëqyrjen e Financave Publike;
 - b. Zyra Kombëtare e Auditimit, Departamenti i pushtetit lokal;
 - c. Asociacionet komunale;
3. Fokus grup me kryetaret e Komiteteve të Auditimit në komunat përkatëse;
4. Vizitë studimore:
 - a. Maqedoni:
 - i. Departamenti i kontrollit të brendshëm të Financave Publike;
 - ii. Zyra kombëtare e Auditimit.
 - b. Shqipëri:
 - i. Departamenti i kontrollit të brendshëm të Financave Publike;
 - ii. Kontrolli i lartë i shtetit të Shqipërisë;
 - iii. Bashkia e Tiranës.

3.3.3 Zgjedhja e mostrës për realizimin e hulumtimit në teren

Bazuar në raportet vjetore të Zyrës Kombëtare të Auditimit të viteve 2012, 2013 dhe 2014, pasi që raportet vjetore për vitin 2015 nuk ka qenë akoma e publikuar në kohën kur është bërë përgatitja e pyetësorëve, ne kemi përzgjedhur 19 Komuna, që përfaqësojnë 50 % të totalit të komunave në Kosovë, dhe që mbulojnë një buxhet me vlerë prej 380,975,368.00 € të buxhetit total të alokuar për Komunitet bazuar në Ligjin për Buxhet¹² të vitit 2015, si dhe me shtrirje territoriale prej 5822.91m² me një popullatë prej 779,379. Një nga kriteret e përzgjedhjes po ashtu ishte edhe diversiteti i komunave bazuar në etni.

¹² Ligji për Buxhet, për vitin 2015

Hulumtimi u bazua në katër komponentë:

1. Komunat e përzgjedhura bazuar në opinionin e kualifikuar të ZAP:
2. Komuna e përzgjedhura në bazë të opinionit të pakualifikuar por me theksim të çështjes:
3. Komunat që përfaqësojnë regjionet:
4. Komunat që janë identifikuar pas takimit me ZAP:

3.4 Rezultatet e Hulumtimit

Hulumtimi në pjesën e parë ka përfshirë pyetësorë të përgatitur bazuar në Kornizën Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale për Auditim të Brendshëm dhe në kërkesat bazike të Standardeve profesionale IIA për funksionimin e auditimit të brendshëm, këto pyetësorë u realizuan nëpërmjet të intervistave.

Në hulumtim kanë marrë pjesë 19 Komuna bazuar në kriteret e sqaruara në pikën e mësipërme, dhe vetëm një nga komunat nuk është përgjigjur në kërkesën tonë. Gjatë periudhës qershor/korrik ne kemi arritur të takojmë 16 Drejtorë të Njësive të Auditimit të Brendshëm në komunat përkatëse dhe 16 Kryetarë Komunash së bashku me dy Nënkryetarë. Intervistat janë realizuar të ndara me qëllim që të mund të merret një input më i mirë dhe objektiv.

Në pjesën në vijim, të gjeturat nga intervistat janë prezantuar në formë tabelore. Është me rëndësi të theksohet që pyetësori ka qenë kombinim në mes të pyetjeve të hapura dhe atyre të mbyllur, si rrjedhojë prezantimi i të gjeturave në tabela është bërë me përgjigjet po/jo/ndoshta, përderisa përgjigjet nga pyetjet e hapura janë përmbledhur në fund të kësaj pjese.

Nga pyetjet dhe përgjigjet mund të shohim që Drejtorët e Njësive të Auditimit të Brendshëm dhe Kryetarët e komunave nuk kanë gjithherë qëndrime të njëjta për po të njëjtat pyetje, këto diferenca na determinojnë disa nga të gjeturat dhe konkluzionet duke u munduar të rekomandohen masa për ngushtimin e boshllëkut në mes të dy palëve.

Pyetësori përmban pesë kapituj kryesorë ato janë: Vendosja Organizative e Auditimit të brendshëm, Menaxhimi i funksionit të Auditimit, Ekzekutimi i detyrave të Auditimit të Brendshëm, impakti i aktivitetit të auditimit në Transparencën Komunale.

Rezultatet e hulumtimit janë paraqitur në vijim.

3.4.1 Vendosja Organizative e Auditimit të Brendshëm

3.4.1.1 Statuti i Auditimit të Brendshëm

1000 - Qëllimi, Autoriteti, dhe Përgjegjësia

Qëllimi, autoritet dhe përgjegjësia e auditimit të brendshëm është e domosdoshme që të jenë të definuara në Statutin e Auditimit të Brendshëm, që konsiston me definicionin për Auditim të Brendshëm, Kodin e Etikës dhe Standardet Profesionale. Kryesuesi i Njësisë së Auditimit të brendshëm duhet që në mënyrë periodike të rishikoj statutin e AB dhe të prezantoj para menaxhmentit të lartë për miratim.

Interpretimi:

Statuti i auditimit të brendshëm është një dokument zyrtar që definon qëllimin e aktivitetit të auditimit, autoritetin dhe përgjegjësinë. Statuti i Auditimit të brendshëm përcakton pozitën e aktivitetin e Auditimit të Brendshëm, duke përfshirë natyrën e raportit në mes të Drejtorit të Auditimit të Brendshëm me bordin, autorizon qasje në regjistër, personel dhe prona fizike relevante për performancën e angazhimit; si dhe definon fushëveprimin e funksionimit të auditimit të brendshëm. Aprovimi final i statutit të auditimit të brendshëm mbetet tek bordi.

1000.A1 - Natyra e shërbimeve të sigurdhënies që ofrohen për organizatën duhet të definojnë saktë në Statutin e AB. Nëse duhet ofruar sigurdhënie edhe jashtë organizatës, kjo gjë po ashtu duhet të definohet në këtë Statut.

1000.C1 - Natyra e shërbimeve të konsulencës duhet të definohet në Statutin e Auditimit të Brendshëm.

	Kryetarët e Komunave			Drejtorët e NjAB-ve		
	Po	Jo	N/N	Po	Jo	N/N
Pyetja 1.1.1: A ekziston Statuti i auditimit të brendshëm dhe a është i nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe Komiteti i Auditimit?	67%	11%	22%	88%	13%	0%
Pyetja 1.1.2: A rishikohet periodikisht statuti i AB dhe nëse duhet a nxirret statuti i ri?	44%	39%	17%	44%	56%	0%
Pyetja 1.1.3. A është në dispozicion statuti i AB për të gjithë të audituarit dhe punonjësit e tjerë që të kuptohet gjerësisht funksioni i auditimit të brendshëm në Komunë?	67%	22%	11%	81%	19%	0%

Tabela 1.1: Statuti i Auditimit të brendshëm

Në hulumtim përgjigjet nga të dyja palët kanë një diskrepancë të konsiderueshme në pyetjen e parë. Drejtorët e Njësive të Auditimit të brendshëm janë përgjigjur që ekziston një Statut i Auditimit të Brendshëm dhe që është i nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe Komiteti i Auditimit të Brendshëm, dhe vetëm 13 % e tyre thanë që Statuti i Auditimit të Brendshëm nuk është i nënshkruar nga Kryetari dhe Komiteti i Auditimit, në anën tjetër Kryetarët kanë opinione ndryshe në këtë përgjigje, 67 % nga ta u përgjigjën me po, 11 % me jo dhe 22 % me nuk e di.

Bazuar në Standardin e përmendur më sipër Statuti i Auditimit të Brendshëm duhet të rishikohet në baza periodike, në këtë pyetje 44 % të Drejtorëve të Auditimit të Brendshëm janë përgjigjur pozitivisht që do të thotë se ata e rishikojnë në periodikisht këtë statut dhe 56 % nuk e rishikojnë. Përderisa në pyetjen e njëjte Kryetarët e Komunave në 44% të rasteve thanë që Statuti rishikohet, 39 % pohuan që nuk rishikohet ndërsa 17 % e Kryetarëve nuk kanë përgjigje për këtë pyetje, që do të thotë nuk e dinë.

Me qëllim që të ekzistoj një qasje e autorizuar në regjistra, personel dhe prona fizike të rëndësishme për performancën e angazhimit dhe për të pasur një definim të qartë të fushëveprimit të auditimit të brendshëm, Statuti i Auditimit të Brendshëm duhet të jetë në dispozicion për të gjithë punëtorët e Subjektit të Audituar, kështu që ata mund të kuptojnë funksionimin e auditimit të brendshëm në Komunë. Nga 16 të intervistuarve nga grupi i Drejtorëve të Njësive të Auditimit të Brendshëm 81 % prej tyre u përgjigjën pozitivisht, 19 % negativisht, ndërsa në anën tjetër ballafaqohemi me një dallim sa i

përket përgjigjeve nga Kryetarët, 67 % nga ta thanë që Statuti i AB është në dispozicion për të gjithë punonjësit, 22 % pohojnë që nuk është në dispozicion ndërsa 11 % prej tyre nuk e dinë ose mendojnë që nuk është në dispozicion.

3.4.1.2 Pozita Organizative e Funkcionit të Auditimit të Brendshëm

1110 – Pavarësia Organizative

Drejtori i Njësisë së Auditimit të brendshëm duhet të raportoj në atë nivel që i lejon atij që të plotësoj përgjegjësitë e tij, ai duhet t'i konfirmoj bordit së paku një herë në vit, pavarësinë organizative të aktivitetit të auditimit të brendshëm.

Interpretimi:

Pavarësia organizative mund të arrihet në mënyrë efektive kur Drejtori i Auditimit raporton para bordit. Shembuj të raportimit funksional të bordit përfshijnë:

- *Aprovimi i statutit të AB;*
- *Aprovimi i planit të auditimit të brendshëm bazuar në rrezik;*
- *Pranimi i formave të komunikimit nga e kryesuesi ekzekutiv i auditimit lidhur me performancën e aktivitetit të auditimit të brendshëm në korrelacion me planin dhe çështjet tjera;*
- *Aprovimi i vendimeve lidhur me emërimin apo shkarkimin e Drejtorit të Auditimit; dhe*
- *Parashtrimi i kërkesave adekuate të menaxhmentit dhe Drejtorit të Auditimit për të përcaktuar nëse ka fushëveprim joadekuat dhe burime të kufizuara.*

1110.A1 - Aktiviteti i Auditimit të brendshëm nuk duhet të ketë interferenca në përcaktimin e fushëveprimit të auditimit të brendshëm, performimit të punës dhe komunikimit të rezultateve.

1111 – Interaksioni direkt me bordin

Drejtori i AB duhet të komunikoj direkt me bordin.

	Kryetarët e Komunave			Drejtorët e NjAB-ve		
	Po	Jo	N/N	Po	Jo	N/N
Pyetja 1.2.1: A është Njësia e AB e vendosur në nivelin më të lartë të Komunës dhe funksionalisht e pavarur nga njësitë e tjera organizative?	100%	0%	0%	100%	0%	0%
Pyetja e 1.2.2 : A ka drejtori i njësisë së AB, komunikim të drejtpërdrejtë me Kryetarin e Komunës dhe menaxhmentin e lartë?	94%	6%	0%	94%	6%	0%

Tabela 1.2: Pozita Organizative e funksionit të AB

Pozita e Auditorit të Brendshëm në strukturën organizative të Organizatave buxhetore tregon shumë lidhur me kapacitetin e Organizatave Buxhetore për dhënë hapësirën dhe autoritetin e duhur Auditorit të Brendshëm që të performoj punën e vet në mënyrë të pavarur. Po ashtu jep mundësi për komunikim direkt me bordin. Në këtë drejtim, hulumtimi ka përfshirë pyetjet e prezantuara në tabelën e mësipërme lidhur me raportimin e Auditorit të Brendshëm para Kryetarit të Komunës dhe pavarësinë e tij funksionale nga njësitë tjera organizative, të gjithë respondentët janë përgjigjur pozitivisht nga të dy grupet.

Duke iu referuar kësaj ne kemi eksploruar po ashtu edhe nivelin e komunikimit direkt të Drejtorit të Njësisë së Auditimit me Kryetarin e Komunës dhe menaxhmentin e lartë të komunës, dhe në 94 % të rasteve është gjetur që ka komunikim direkt ndërmjet dy palëve dhe vetëm në 6% të rasteve nuk ekziston një komunikim i tillë.

3.4.1.3 Pavarësia e Auditorit të Brendshëm

1120 – Objektiviteti Personal

Auditorët e brendshëm duhet të kenë qëndrim të definuar në drejtim të shmangies së konfliktit të interesit.

Interpretimi:

Konflikti i interesit është një situatë në të cilën auditori i brendshëm është në një pozitë me bazë besimin, ka interes profesional dhe personal konkurruese. Ky interes konkurrues mund të paraqes vështirësi për përmbushjen e disa detyrave në mënyrë të paanshme. Konflikti i interesit ekziston edhe nëse nuk shfaqen rezultate jo etike dhe jo të përshtatshme. Konflikti i interesit mund të shkaktoj situata që e dëmtojnë besimin e auditorit të brendshëm, aktivitetin e auditimit të brendshëm dhe profesionin. Konflikti i interesit mund të pengoj performimin e punëve dhe demonstrimin e përgjegjësisë në mënyrë objektive.

1130 - Dëmtimi i pavarësisë ose objektivitetit

Nëse dëmtohet pavarësia ose objektiviteti, kjo gjë duhet të shpaloet para palëve të duhura. Natyra e shpalosjes varet nga shkalla e dëmtimit dhe lloji i tij.

Interpretimi:

Dëmtimi i pavarësisë organizative ose objektivitetit personal, mund të përfshijë duke mos u kufizuar: konflikt interesi personal, kufizime të caktuara, restriksione për qasje ne regjistra, personel dhe prona si dhe kufizime në burime siç mund të jetë financimi.

Përcaktimi i palëve para të cilave duhet të bëhet shpalosja e dëmtimit të pavarësisë apo objektivitetit varet nga pritjet e aktivitetit të auditimit të brendshëm dhe përgjegjësisë së drejtorit të auditimit të brendshëm ndaj menaxhmentit të lartë ose bordit, gjithmonë duke iu referuar statutit të auditimit të brendshëm dhe natyrës së dëmtimit.

1130.A1 - Auditorët duhet të distancohen nga vlerësimi i operacioneve specifike për të cilat kanë qenë përgjegjës më herët. Objektiviteti llogaritet që mund të dëmtohet nëse auditori i brendshëm ofron shërbime të sigurdhënies për një aktivitet për të cilin ai ka qenë përgjegjës në vitin e kaluar.

1130.A2 - Angazhimet e siguridhënies për funksionet për të cilat drejtori i auditimit të brendshëm ka qenë përgjegjës duhet të realizohen nga ndonjë palë jashtë aktivitetit të auditimit të brendshëm.

1130.C1 - Auditorët e brendshëm mund të ofrojnë shërbime këshilluese lidhur me operacionet për të cilat ata kanë pasur përgjegjësi më herët.

1130.C2 - Nëse auditorët e brendshëm shohin mundësi të dëmtimit të pavarësisë ose objektivitetit lidhur me shërbimet e propozuara të këshillimit, duhet të bëhet shpалosja e tyre para klientit para se të pranohet angazhimi.

	Kryetarët e Komunave			Drejtorët e NjAB-ve		
	Po	Jo	N/N	Po	Jo	N/N
Pyetja 1.3.1 A janë bërë aranzhimet adekuate, për t'u siguruar që auditorët e brendshëm, ju shmangen çfarëdo konflikti potencial të interesit?	94%	0%	6%	94%	6%	0%
Pyetja 1.3.2 A keni bërë aranzhimet adekuate për t'u siguruar që Auditorët e brendshëm, nuk janë përfshirë në kryerjen e auditimeve në fushat për të cilat ata mund të kenë qenë përgjegjës para se të i bashkohen njësisë së AB-së, siç kërkohet me ligj?	56%	39%	6%	100%	0%	0%
Pyetja 1.3.3 A informohen/njoftohen auditorët e brendshëm me ndryshimet e rëndësishme që kanë ndodhur në Komunë në periudhën e fundit? (legjislacioni i ri, dokumentet e reja strategjike, raportet e ZAP, etj.). Po me ndryshimet në ligjet dhe UA nga niveli qendror?	100%	0%	0%	88	12%	0%

Tabela 1.3: Pavarësia e auditorit

Drejtorët e Njërive të Auditimit të brendshëm janë pyetur nëse janë të vendosura gjitha rregullat adekuate që sigurojnë që auditorët e brendshëm i shmangen çfarëdo lloji të konfliktit të interesit dhe

përgjigjja në këtë pyetje ishte e kënaqshme ku 96 % e respondentëve thanë që janë të vendosura rregullat e duhura dhe vetëm 6 % e tyre thanë që nuk ekzistojnë këto rregulla. Kryetarët e komunave ndajnë po të njëjtin mendim për këtë çështje.

Për të rikonfirmuar këtë është parashtruar edhe një pyetje tjetër lidhur me angazhimin e auditorëve në fushat ku ata kanë qenë përgjegjës para se t'i bashkohen njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe unanimisht përgjigjja ishte jo, me 100 % mbulesë. Por kryetarët e komunave janë përgjigjur ndryshe në këtë pyetje, 56% nga ta thanë që po ata janë të përfshirë në angazhime të llojit të tillë, ndërsa 39 % u përgjigjën me jo.

Një e gjetur shqetësuese lidhur me pavarësinë e auditorëve të brendshëm ishte ajo që në pyetjen që ka të bëjë me angazhimin e auditorëve të brendshëm në detyra tjera përpos auditimit nga ana e menaxhmentit apo kryetarit të komunës, 13 % e auditorëve të brendshëm u përgjigjën me po ndërsa 88 % me jo. Përderisa 6 % nga kryetarët e komunave pohuan që i angazhojnë auditorët e brendshëm edhe në detyra tjera dhe 94 % e tyre u përgjigjën me jo në këtë pyetje.

3.4.1.4 Kualifikimi për Auditorë të Brendshëm dhe Kompetenca

1220 – Kujdesi i duhur profesional

Auditorët e brendshëm duhet që të jenë të kujdesshëm dhe që të kenë aftësitë e duhura për të performuar ashtu si duhet. Kujdesi i duhur profesional nuk nënkupton pagabueshmëri.

1220.A1 - Auditorët e brendshëm duhet të kenë kujdesin e duhur profesional

- Ndërmarrja e masave të nevojshme për arritjen e objektivave të angazhimit;
- Komplexiteti, materialiteti, ose rëndësia relative e çështjeve për të cilat aplikohen procedurat e siguridhënies;
- Përshtatshmëria dhe efektiviteti i qeverisjes, menaxhimit të rrezikut dhe proceseve të kontrollit.
- Probabiliteti i gabimeve të signifkancës, mashtrimit apo mospërputhshmërisë, dhe
- Kostot e siguridhënies në raport me beneficinet potenciale.

1220.A2 - Me zbatimin e kujdesit të duhur profesional auditorët e brendshëm duhet domosdoshmërisht të konsiderojnë përdorimin e auditimit nëpërmjet teknologjisë dhe teknikave tjera të analizimit të të dhënave.

1220.A3 - Auditorët e brendshëm duhet të jenë vigjilent lidhur me rreziqet signifikante që mund të afektojnë objektivat, operacionet, ose burimet. Sidoqoftë, vetëm procedurat e siguridhënies, edhe nëse zhvillohen në bazë të kujdesit të duhur profesional nuk garantojnë identifikimin e gjitha rreziqeve signifikante.

1220.C1 - Auditorët e brendshëm duhet të kenë kujdes profesional gjatë angazhimit të tyre në këshillim duke konsideruar:

- Nevojat dhe pritjet e klientëve, duke përfshirë natyrën, afatin kohor dhe komunikimin e rezultateve;
- Kompleksitetin relative dhe shtrirjen e nevojshme të punës për arritjen e objektivave të angazhimit; dhe
- Koston e angazhimit në këshillim në raport me beneficionet potenciale.

1230 - Zhvillimi i vazhdueshëm profesional

Auditorët e brendshëm duhet të shtojnë njohuritë, shkathtësitë e tyre dhe kompetencat nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional.

Interpretimi: Auditorët e brendshëm duhet të jenë të kujdesshëm lidhur me rreziqet me të cilat mund të ballafaqohet organizata. Në të njëjtën kohë ata duhet të jenë të pajisur me njohuri dhe shkathtësi lidhur me performimin e punës së tyre.

	Kryetarët e Komunave			Drejtorët e NjAB-ve		
	Po	Jo	N/N	Po	JO	N/N
1.4.1 A posedojnë të gjithë auditorët e komunës suaj kualifikimet adekuate për ushtrimin e profesionit të auditimit të brendshëm?	83%	11%	0%	94%	6%	0%
1.4.2 A keni ndërmarrë diçka për të kualifikuar ata auditor që nuk janë të kualifikuar ende?	56%	44%	0%	75%	25%	0%
Pyetja 1.4.3 A ndjekin auditorët ndonjë program trajnimi për Arsimimin e vazhdueshëm profesional?	83%	0%	17%	81%	19%	0%
Pyetja 1.4.4 Nëse duhet të ndiqni ndonjë trajnim, a keni përkrahjen e menaxhmentit?				56%	31%	6%

Tabela 1.4: Kualifikimi dhe kompetenca e auditorëve të brendshëm

Kjo pjesë adreson pyetjen më të zakonshme dhe të diskutueshme lidhur me kualifikimin adekuat të auditorëve të brendshëm në komuna për ushtrimin e detyrës së tyre, në këtë rast 94% të auditorëve kanë pohuar që kanë kualifikim të mjaftueshëm dhe të duhur dhe 6% prej Drejtorëve të njësive të Auditimit të Brendshëm kanë thënë që nuk kanë kualifikimin e duhur për këtë detyrë, përderisa 83% e kryetarëve të komunave konsiderojnë që auditorët e brendshëm në komunat përkatëse kanë kualifikim adekuat dhe 11% e tyre mendojnë që auditorët e brendshëm nuk kanë kualifikim adekuat.

Në pyetjen lidhur me masat e ndërmarra për kualifikimin e auditorëve të brendshëm aty ku është e nevojshme, 75% të drejtorëve të njësive të AB janë përgjigjur që janë marrë masat e nevojshme dhe 25% prej tyre mendojnë që nuk është ndërmarrë asgjë në këtë drejtim. Ndërsa sa i përket kryetarëve të komunave kemi një mendim pak më ndryshe, 56% e kryetarëve mendojnë që janë marrë veprimet e nevojshme për kualifikimin e auditorëve të brendshëm sipas nevojës dhe 44% mendojnë që nuk është ndërmarrë ndonjë veprim i tillë.

Që të mirëmbahet kualifikimi ekziston një kërkesë për zhvillim të vazhdueshëm profesional e ofruar

nëpërmjet një skeme speciale që ofron njohuri të ndryshme të rëndësishme për punën e përditshme të auditorit të brendshëm. 81% e respondentëve nga grupi i drejtorëve të njësive të Auditimit të Brendshëm janë përgjigjur me po dhe 19% e tyre me jo. Përderisa sa i përket kryetarëve të komunave 83 % e tyre mendojnë që Auditorët e Brendshëm ndjekin AVP ndërsa 17% kanë thënë që ata nuk janë pjesë e këtij procesi ose të paktën nuk kanë njohuri në këtë drejtim.

Për të arritur kualifikimin e duhur dhe për të ndjekur skemën e zhvillimit të nevojshëm të vazhdueshëm profesional duhet që të merret kohë nga puna kështu që mund të ketë interferencë në punën e planifikuar të auditorëve. Kështu që pyetja tjetër ka adresuar çështjen e përkrahjes nga ana e menaxhmentit në lidhur me çështjet e lartpërmendura, 56% e respondentëve nga grupi i drejtorëve të njësive të auditimit të brendshëm pohojnë që kanë përkrahje nga menaxhmenti, 31% mendojnë që nuk kanë përkrahje nga menaxhmenti dhe 6% nuk kanë ndonjë mendim të caktuar.

Që auditorët të zhvillojnë detyrat e tyre ata duhet të informohen lidhur me ndryshimet e rëndësishme që kanë ndodhur në komunë (ligje të reja, dokumente të reja strategjike, raportet e ZAP etj.). Në këtë pyetje 88% të auditorëve të brendshëm (DNjAB) janë përgjigjur që janë të njoftuar për ndryshimet dhe 12% që nuk janë të njoftuar me ndryshimet, përderisa kryetarët e komunave pohojnë të gjithë që auditorët e brendshëm janë të njoftuar me ndryshimet që ndodhin në komunë.

Përfundime: Pozicionimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm për të raportuar direkt para Kryesuesit të Organizatës Buxhetore, krijon një mjedis të pavarur pune, megjithatë Kryetarët e Komunës duhet të sigurohen që Statutet e Auditimit janë të nënshkruara (miratuara) dhe të azhurnuara gjatë gjithë kohës. Auditorët duhet të kenë në mënyrë të vazhdueshme komunikim me menaxhmentin. Drejtorët e njësive të auditimit të brendshëm duhet të ndërmarrin gjithë hapat që të mbrohen nga konfliktet e mundshme të interesit duke mos u angazhuar në punë tjera ku kanë qenë përgjegjës më herët. Pavarësia dhe kualifikimi janë dy shtyllat kryesore të auditimit të brendshëm, subjekt i të cilave shtylla duhet të jenë të gjithë auditorët dhe menaxhmenti duhet t'i mbështesë ata në këtë drejtim.

3.4.2 Menaxhimi i funksionit të Auditimit të Brendshëm

Funksioni i Auditimit të Brendshëm bazuar në Standarde/ Standardi 2010 planifikimi që përfshinë përgatitjen e Planeve vjetore strategjike dhe procedurave të punës së Auditimit të brendshëm

3.4.2.1 Planifikimi Strategjik dhe Vjetor i Auditimit të Brendshëm

Standardet e Performancës

2000 – Menaxhimi i aktivitetit të Auditimit të Brendshëm

Udhëheqësi ekzekutiv duhet që në mënyrë efektive të menaxhoj aktivitetin e auditimit të brendshëm, që të sigurohet që është vlerë e shtuar për organizatën.

Interpretimi:

Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm menaxhohet efektivisht kur:

- *Rezultatet e punës së auditimit të brendshëm arrijnë qëllimin dhe përgjegjësitë të përfshira në statutin e Auditimit të Brendshëm;*
- *Aktiviteti i auditimit të brendshëm është në harmoni me definicionin e Auditimit të Brendshëm dhe Standardet;*
- *Individët që janë pjesë e aktivitetit të auditimit demostrojnë respektim të Kodit të Etikës dhe Standardeve.*

Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm është vlerë e shtuar për organizatën (dhe akterët tjerë) kur ofron sigurdhënie objektive dhe të rëndësishme që kontribuon në efektivitetin dhe eficiencën e qeverisjes, menaxhimit të riskut dhe proceseve të kontrollit.

2010 – Planifikimi

Kryesuesi ekzekutiv i Auditimit duhet të përgatis plane bazuar në rreziqe me qëllim të determinimit të prioriteteve të aktivitetit të auditimit të brendshëm, konsistente me qëllimet e organizatës.

Interpretimi:

Kryesuesi Ekzekutiv i Auditimit është përgjegjës për zhvillimin e planit bazuar në rrezik dhe duhet të merr në konsideratë kornizën e organizatës për menaxhimin e rrezikut, përfshirë përdorimin e niveleve të oreksit të rrezikut të përcaktuara nga menaxhmenti për aktivitete të ndryshme ose pjesë të organizatës. Nëse nuk ekziston një kornizë, Kryesuesi ekzekutiv i auditimit përdorë qëndrimin e vet për rreziqet pasi të konsultohet me menaxhmentin e lartë dhe bordin.

2010.A1- Plani i angazhimeve të auditimit të brendshëm duhet të bazohet në dokumentimin e vlerësimeve të rrezikut, që ndërmerren minimalisht një herë në vit. Inputi i menaxhmentit të lartë dhe bordit duhet të konsiderohet në këtë proces.

2010.A2 - Kryesuesi ekzekutiv i auditimit duhet të identifikoj dhe konsideroj pritjet e menaxhmentit të lartë, bordit dhe akterëve tjerë për opinionet e auditimit të brendshëm dhe konkluzionet tjera.

2010.C1- Kryesuesi ekzekutiv i auditimit duhet të konsideroj pranimin e angazhimeve të propozuar të këshillimit bazuar në potencialin e angazhimit për përmirësimin e menaxhimit të rreziqeve, shtimin e vlerës dhe përmirësimin e operacioneve të organizatës. Angazhimet e pranuar duhet të përfshihen në plan.

	Kryetarët e Komunave			Drejtorët e NjAB-ve		
	Po	Jo	N/N	Po	Jo	N/N
Pyetja 2.1.1: A ndërlidhet plani strategjik i auditimit me Objektivat Strategjike të Komunës?	100%	0%	0%	94%	6%	0%
Pyetja 2.1.2 A është miratuar plani strategjik dhe vjetor i AB nga Komiteti i auditimi dhe Kryetari i Komunës?	94%	6%	0%	94%	6%	0%
Pyetja 2.1.3 A kontaktoheni nga Njësia e AB para përgatitjes së Planit strategjik për AB dhe a jepni kontribut?	31%	69%	0%			
Pyetja 2.1.3 A ka pasur komente/propozime shtesë nga Komiteti i Auditimit lidhur me Planin strategjik dhe vjetor të AB?				31%	69%	0%
Pyetja 2.1.4 A kontaktohet menaxhmenti dhe ju jep ndonjë kontribut për përgatitjen e Planit strategjik për AB?				81%	19%	0%
Pyetja 2.1.7 A ka kërkesa të tjera për auditimet gjatë vitit, me kërkesë të menaxhmentit?	78%	17%	6%	69%	31%	0%
Pyetja 2.1.8 A i është ofruar të audituarve Plani vjetor i AB?	88%	6%	6%	88%	13%	0%

Tabela 2.1: Planifikimi Strategjik dhe vjetor i auditimit të brendshëm

Në pyetjen nëse planet strategjike të auditimit të brendshëm lidhen me objektivat strategjike të komunave, kryetarët e komunave janë përgjigjur në 100% të rasteve me po, ndërsa drejtorët e njësive të auditimit të brendshëm në 94% të rasteve janë përgjigjur me po dhe 6% me jo.

Në pyetjen që ka të bëjë me aprovimin e planeve strategjike dhe vjetore nga ana e kryetarëve të

komunave dhe komiteteve të auditimit 94% u përgjigjën pozitivisht dhe 6% negativisht.

Pikërisht në këtë çështje janë pyetur kryetarët e komunave nëse kontaktohen nga njësitë e auditimit të brendshëm gjatë përgatitjes së planeve strategjike të auditimit të brendshëm dhe a japin ata kontribut, ku është marrë një përgjigje jo mjaftë e kënaqshme, në 69% të rasteve ata nuk japin një kontribut të tillë dhe në 31% të rasteve po.

Në pyetjen në vijim të drejtuar vetëm për drejtorët e Njësive të Auditimit të brendshëm lidhur me komentet/propozimet për komitetet auditimit lidhur me planet strategjike dhe planet vjetore të auditimit të brendshëm, 69% e DNjAB janë përgjigjur që nuk ka komente/propozime shtesë nga komiteti i auditimit, ndërsa në 31 % të rasteve pohojnë që komitetet e japin kontributin e tyre.

Menaxhmenti i komunës duhet që të kontribuoj në përgatitjen e Planit Strategjik të auditimit të brendshëm si dhe planin vjetor konsektiv, dhe në fund të procesit duhet ta nënshkruaj si formë marrëveshje lidhur me objektivat dhe fushëveprimin e Aktivitetit të Auditimit të Brendshëm. Lidhur me këtë drejtorët e njësive të Auditimit të Brendshëm janë pyetur nëse menaxhmenti kontaktohet dhe nëse ata japin ndonjë kontribut në përgatitjen e planit strategjik të auditimit të brendshëm, përgjigja në këtë pyetje ishte në nivelin e kënaqshëm me 81% përgjigje pozitive dhe 19% përgjigje negative.

Lidhur me modalitetin e komunikimit, 56% e tyre kanë thënë që komunikimi realizohet nëpërmjet takimeve dhe nëpërmjet të komunikimit me shkrim, 26% kanë thënë që komunikimi realizohet nëpërmjet takimeve të rregullta dhe 1 është përgjigjur që komunikimi realizohet vetëm me shkrim.

Në përcaktimin e procesit që derivon nga pyetja 2.1.1 në bashkërendimin e objektivave strategjike të auditimit të brendshëm dhe si ato janë korelative me objektivat e Komunës dhe prioritetet e Menaxhmentit, përgjigjet e drejtorëve të njësive të AB ishin të ndryshme. Në përgjithësi planet e tyre janë në bashkërendim me objektivat e komunës, por ndonjëherë ata po ashtu përgatisin planet e tyre bazuar në takimet që kanë me menaxhmentin, bazuar në KASH, buxhet dhe rrallë në rreziqe.

Menaxhmenti mund të kërkoj auditime ad-hoc nga njësitë e Auditimit të Brendshëm gjatë vitit. Auditimet ad-hoc janë auditime që nuk i takojnë planit vjetor të auditimit dhe prandaj nuk janë të parapara në planin strategjik që do të thotë që auditorët e brendshëm duhet që paraprakisht të planifikojnë që të lënë hapësirë rreth 10-15% të kohës për të mbuluar kërkesat e auditimeve ad-hoc. Në pyetjen tonë për të dy grupet, Drejtorët e njësive të AB dhe Kryetarët e Komunave nëse ekzistojnë kërkesa të tilla, përgjigjet e tyre ishin: Kryetarët në 78% të rasteve u përgjigjën me po, në 17% të

rasteve me jo dhe 6% me nuk e di. Në anën tjetër drejtorët e njësisve të Auditimit të Brendshëm në 69% të rasteve u përgjigjën me po dhe në 31% të rasteve me jo.

Pyetja u ndoq nga një tjetër pyetje e hapur për të përcaktuar nëse kjo gjë e tejkalon shumë e lejuar për t'u alokuar për këto lloje të auditimit dhe në përgjithësi mesatarja ishte në mes të 15-20% të auditimeve.

Pyetja e fundit e kësaj pjese ishte nëse plani vjetor ofrohet/komunikohet deri te të audituarit, është me rëndësi që edhe stafi i mbetur i organizatës buxhetore të informohet kur do të auditohen ata ose cila pjesë e proceseve të tyre dhe sistemeve do të jetë pjesë e auditimit. Shumica e përgjigjeve nga të dyja grupet ishte me shumice përgjigje pozitive.

3.4.2.2 Komunikimi në mes të Kryetarit të Komunës dhe Komitetet e Auditimit lidhur me planet e Auditimit të brendshëm.

Reference në IPPF IA: **Standard 2020/2060 Komunikimi dhe aprovimi/raportimi para menaxhmentit dhe bordit.**

2020 – Komunikimi dhe aprovimi

Shefi Ekzekutiv i Auditimit duhet që të paraqes para menaxhmentit të lartë dhe bordit planet e aktivitetit të auditimit të brendshëm si dhe kërkesat e burimeve, duke përfshirë ndryshimet e rëndësishme për rishikim dhe aprovim. Shefi ekzekutiv i auditimit duhet po ashtu të prezantojë lidhur me ndikimin e kufizimeve në burime.

2060 - Raportimi para menaxhmentit të lartë dhe Bordit

Shefi ekzekutiv i auditimit duhet që të raportoj në baza periodike para menaxhmentit të lartë dhe bordit lidhur me qëllimin, autoritetin, përgjegjësinë dhe performancën relative të planit. Raportimi duhet të përfshijë po ashtu edhe parashikimet e rreziqeve dhe çështjet e kontrollit, përfshirë rreziqet nga mashtrimi, qeverisja dhe çështje tjera të nevojshme ose të kërkuara nga menaxhmenti i lartë dhe bordi.

Interpretimi:

Frekuenca dhe raportimi janë të përcaktuara në diskutim me menaxhmentin e lartë dhe bordin dhe varen nga rëndësia e informacioneve që duhet të komunikohen dhe urgjenca e veprimeve të lidhura që duhet të ndërmerren nga menaxhmenti ose bordi.

	Kryetarët e Komunave			Drejtorët e NJAB-ve		
	Po	Jo	N/N	Po	Jo	N/N
Pyetja 2.1.1: A ndërlidhet plani strategjik i auditimit me Objektivat Strategjike të Komunës?	94%	6%	0%	88%	6%	6%
Pyetja 2.1.2 A është miratuar plani strategjik dhe vjetor i AB nga Komiteti i auditimi dhe Kryetari i Komunës?	59%	29%	12%	75%	25%	0%
Pyetja 2.1.3 A kontaktoheni nga Njësia e AB para përgatitjes së Planit strategjik për AB dhe a jepni kontribut?	82%	0%	18%			
Pyetja 2.1.3 A ka pasur komente/propozime shtesë nga Komiteti i Auditimit lidhur me Planin strategjik dhe vjetor të AB?				31%	69%	0%

Tabela 2.2: Komunikimi me Kryetarin e Komunës dhe Komitetin e Auditimit lidhur me planet e auditimit

Përderisa komunikimi nuk kërkohet vetëm me standard por po ashtu është një nga pesë elementet e Kornizës COSO, dhe është mënyra e vetme për të maksimizuar përfitimet e cilësdo punë në veçanti punës së auditimit, Drejtorët e Auditimit të Brendshëm dhe Kryetarët i janë përgjigjur të njëjtës pyetje lidhur me komunikimin, që përfaqësonin opinione të ndryshme.

Në pyetjen e parë në këtë nën-kapitull lidhur me raportimin e DNjAB në mënyrë periodike para Kryetarit të Komunës dhe Komitetit të Auditimit lidhur me implementimin e planeve të auditimit, Kryetarët u përgjigjën pozitivisht në 94 % të rasteve dhe DNjaB po ashtu në 88 % përqind të rasteve u përgjigjën me po.

Në pyetjen e dytë nëse NJAB merr përgjigje nga Kryetari / Komiteti i auditimit bazuar në raportet e pranuar, dhe nëse ata propozojnë ndonjë veprim, Kryetarët u përgjigjën me po në 59 % të rasteve, me jo në 29 % të rasteve dhe të tjerët nuk kanë pasur ndonjë përgjigje, në anën tjetër drejtorët konfirmuan se ata pranojnë përgjigje dhe sygjerime nga Kryetarët dhe Komitetet e Auditimit, përjashtimisht 25 % të rasteve.

Pyetja e fundit për të përmbledhur këtë seksion ishte nëse Komitetet e auditimit komunikojnë sipas nevojës me drejtorët e NjAB-së, në këtë pyetje kryetarët u përgjigjën që po ekziston ky komunikim në shumicën e rasteve. Situata pothuajse e ngjashme ishte edhe në përgjigjën e DNjAB ku 94 % e tyre i përgjigjën pozitivisht.

Përfundim:

Menaxhimi i aktivitetit të auditimit të brendshëm nuk është aq i thjeshtë sa mund të duket, pasi që aty janë të përfshirë edhe palë tjera në proces. Ndonjëherë, auditimi i brendshëm konsiderohet të jetë jo efektiv në kuptimin e konsumimit të kohës për të audituarit, dhe në të shumtën e rasteve mund të duket që nuk paraqet ndonjë vlerë të shtuar për punën e tyre në krahasim me kohën që kërkohet për përgatitjen e dokumenteve dhe takimet e mbajtura.

Një planifikim strategjik vjetor i mirë është crucial që determinon suksesin e DNjAB në menaxhimin e aktivitetit dhe në të njëjtën kohë, është vlerë e shtuar për organizatën. Po ashtu Auditorët e Brendshëm duhet të përfshijnë Menaxhmentin në përgatitjen e planeve strategjike para se t'i dërgojnë ato për aprovim, dhe pas aprovimit t'i shpërndajnë për të gjithë të audituarit në organizatën buxhetore.

3.4.3 Ekzekutimi i angazhimeve të Auditimit të Brendshëm – Procesi i Auditimit të Brendshëm **Standardi 2040 Politikat dhe Procedurat**

2040 – Politikat dhe Procedurat

Shefi Ekzekutiv i auditimit duhet të vendos politika dhe procedura për të udhëhequr aktivitetin e auditimit.

Interpretimi:

Forma dhe përmbajtja e politikave dhe procedurave janë të varura nga madhësia dhe struktura e aktivitetit të auditimit të brendshëm si dhe nga kompleksiteti i punës, andaj Auditori i Brendshëm duhet që të sigurohet që ajo që është planifikuar do të arrihet dhe raportimi në implementimin e aktiviteteve është bërë me kohë, i ndjekur nga përgatitja e planeve të veprimit për implementimin e rekomandimeve.

	Kryetarët e Komunave			Drejtorët e NjAB-ve		
	Po	Jo	N/N	Po	Jo	N/N
Pyetja 3.1.1 A janë realizuar të gjitha auditimet e planifikuara për vitin e kaluar?	83%	11%	6%	88%	13%	0%
Pyetja 3.1.3 A janë përfunduar me kohë të gjitha raportet për auditimet e kryera?	89%	6%	6%	100%	0%	0%
Pyetja 3.1.4 A i ka përgatitur menaxhmenti planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të AB?	72%	17%	11%	69%	31%	0%

Tabela 3.0: Ekzekutimi i angazhimit të AB

Kur është parashtruar pyetja nëse gjitha auditimet e planifikuara janë implementuar në vitin e kaluar, kryetarët u përgjigjën me po në 83 % të rasteve dhe me jo në 11 % të rasteve, ndërsa 6 % prej tyre nuk kishin njohur, ndërsa DNjAB u përgjigjën pozitivisht në 88 % të rasteve dhe me jo pjesa e mbetur.

Pyetja vijuese 3.2.2, ishte lidhur me auditimit e vitit aktual lidhur me atë se si po ecë implementimi i aktiviteteve të auditimit të brendshëm, përgjigjja ishte e kënaqshme nga shumica e DNjAB.

Përfundim: Raportimi është faza e tretë e procesit të Auditimit të Brendshëm dhe është përgjegjësi e DNjAB-së që të finalizoj raportin me kohë dhe të njëjtin ta dorëzoj tek menaxhmenti për të përgatitur planet e veprimit lidhur me adresimin e rekomandimeve të Auditorit të Brendshëm.

3.4.4 Impakti i aktivitetit të Auditimit të Brendshëm

Standardi 2500 Procesi i Monitorimit

3.4.4.1 Përcjellja e rekomandimeve të auditimit të brendshëm

2500 – Monitorimi i Progresit

Shefi Ekzekutiv i auditimit duhet të themeloj dhe të mirëmbaj një sistem për monitorimin e rezultateve të cilat komunikohen para menaxhmentit. **2500.A1-** Shefi ekzekutiv i auditimit duhet të krijoj një proces monitorimi të ndjekjes së rekomandimeve që të sigurohet që menaxhmenti po ndërmerr veprimet duhura ose që janë pranuar rreziqet e mos marrjes së veprimit.

	Kryetarët e Komunave			Drejtorët e NjAB-ve		
	Po	Jo	N/N	Po	Jo	N/N
Pyetja 4.1.1 A është krijuar baza e të dhënave për rekomandimet e dhëna dhe a azhurnohet/mirëmbahet rregullisht ajo?	72%	22%	6%	88%	13%	0%
Pyetja 4.1.2 A është vendosur procedura përcjellëse për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të dakorduara të AB?	72%	17%	11%	88%	6%	6%
Pyetja 4.1.3 A raportohen tek Kryetari i Komunës dhe Komiteti i Auditimit, rekomandimet e pazbatuara ose që janë ende pezull.	78%	22%	0%	94%	6%	0%
Pyetja 4.1.4 Sipas mendimit tuaj, sa efektiv është Departamenti i Auditimit të Brendshëm në promovimin e etikës dhe vlerave në kuadër të organizatës?	28%	61%	11%	19%	81%	0%
Pyetja 4.1.5 A ka demonstruara Departamenti i Auditimit të Brendshëm përpjekjet për të minimizuar dyfishimin punëve ndërmjet zyrtareve?	33%	44%	22%	81%	6%	6%

Tabela 4.1: Përcjellja e rekomandimeve të auditimit të brendshëm

Duke marrë parasysh faktin që planifikimi i auditimit lejon një kohë të caktuar për ndjekjen e rekomandimeve, është i domosdoshëm ekzistimi i një sistemi të mirëfilltë i dedikuar për këtë qëllim, i cili do mundësonte azhurnimin e rregull, përgjigjet ishin pozitive në shumicën e rasteve nga të dyja grupet.

Në pyetjen lidhur me vendosjen e një sistemi për monitorimin e implementimit të rekomandimeve për auditim të brendshëm, 72 % e kryetarëve u përgjigjën me po dhe 17% me jo përderisa 11 % e tyre nuk e dinë. Drejtorët e NjAB u përgjigjën pozitivisht në 88 % të rasteve.

Një pjesë e rëndësishme e fazës së ndjekjes së rekomandimeve është po ashtu implementimi i rekomandimeve, posaçërisht rekomandimet që ngelen të pazbatuara ose janë në proces. Ky raportim duhet të shkoj nga Nja deri të Kryetarët e Komunave dhe Komitetet e Auditimit. Lidhur me këtë proces shumica u përgjigjën pozitivisht nga të dyja grupet.

Në pyetjen lidhur me efektivitetin e Departamentit të Auditimit të Brendshëm në promovimin e etikës dhe vlerave brenda organizatës, në mënyrë të përshkallëzuar kryetarët mendojnë se ky departament është shumë efektiv në këtë drejtim në 28 % të rasteve, 61 % prej tyre thanë që ata janë efektiv, dhe 11% thanë që Departamenti i auditimit të brendshëm janë pak efektiv.

Një nga detyrat e auditorëve të brendshëm në sistemin e menaxhimit financiar është që ata duhet të përpiqen për të minimizuar dyfishimin e punës për zyrtarët që punojnë në organizatat buxhetore. Në pyetjen lidhur me këtë çështje kemi një përgjigje më të larmishme, 44% e kryetarëve mendojnë që NjAB nuk përpiqet mjaftueshëm në këtë drejtim, 33% mendojnë që ata japin përpjekjen e duhur, dhe 22% nuk kanë dhënë ndonjë mendim të caktuar.

Përfundim: Faza e fundit e procesit të auditimit është ndjekja e rekomandimeve. Kjo fazë, në fakt paraqet vlerën e shtuar të organizatës që e japin auditorët e brendshëm pasi që ndihmon përmirësimin e procesit. Kjo gjë nuk është një detyrë edhe aq e lehtë pasi që në këtë proces janë të përfshirë më shumë njerëz që janë të përcaktuar për të bërë ndryshime të cilat janë paraqitur në planet e veprimit dhe në praktikë ndodhë që kjo gjë të çaloj në funksionim. Duke e pasur këtë situatë kemi shume rekomandime të cilat nuk zbatohen ose mbesin pezull.

3.4.5 Transparenca në Komuna

Në pjesën e pestë dhe të fundit të pyetësorit është trajtuar çështja e transparencës së Komunave të cilat janë të obliguara të jenë transparente para qytetarëve dhe të japin llogari lidhur me shpenzimin e parave publike.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka aprovuar vitin e kaluar udhëzimin administrativ për transparencën në komuna ku janë të përfshira disa nga kriteret të cilat duhet t'i plotësoj komuna. Ky është një hap shumë i vogël dhe len për të dëshiruar në drejtim të përmirësimit të transparencës komunale. Lidhur me këtë pikë ishte e parashtruar një pyetje për të dyja grupet që ka të bëjë me kontributin e tyre në drejtim të rritjes llogaridhënies dhe rrjedhimisht transparencës. Në gjashtë pyetje të hapura, dy grupet e përfshira në hulumtim kanë dhënë opinionin e tyre në pyetjet në vijim:

Si mund të mbështetet Kryetari/Drejtori i Njësisë së Auditimit të Brendshëm në punën e tij të përditshme nga secili prej tyre. Në këtë pyetje përgjigjet ishin shumë të ndryshme, por dominon opinion që Kryetarët e Komunave në përgjithësi nuk e vlerësojnë mjaftueshëm rolin e auditorit të

brendshëm, duke pritur që auditori i brendshëm duhet të ushtroj kontroll mbi punën e tjerëve dhe implementoj ligjet dhe rregulloret relevante.

Vetëm një numër i vogël i kryetarëve e kanë kuptuar në të vërtetë rolin e auditorëve të brendshëm duke theksuar funksionin e tyre si mbështetës për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së komunës.

Drejtorët e Njësive të Auditimit të Brendshëm në shumicën e rasteve thanë që mbështetja më e madhe për njësitë e auditimit të brendshëm është zbatimi i rekomandimeve, përgatitja e regjistrave të rreziqeve dhe staf i mjaftueshëm në njësi.

Në pyetjen e dytë lidhur me ndihmën që Kryetari mund të ofroj për Auditorët e brendshëm që është një nga elementet kyç i këtij projekti duke e ditur që Kryetari është në krye të zinxhir të llogaridhënies, ata mendojnë që mund të mbështesin auditorët e brendshëm nëpërmjet dhënies së rekomandimeve. Në anën tjetër, disa nga Drejtorët kanë përshtypjen që nuk luajnë ndonjë rol të madh në Zinxhirin e Llogaridhënies, përveç se ndihmojnë kryetarin e komunës me rekomandime dhe këshilla.

Përderisa komunikimi dhe informimi është kyç në realizimin e detyrave dhe është një nga pesë elementet e COSO-s13, është me rëndësi të kemi opinionin e dy grupeve lidhur me këtë çështje. Në pyetjen se si funksionon komunikimi në mes të Kryetarit të Komunës dhe menaxhmentit të lartë, Drejtorit të NjAB-së, Komitetit të Auditimit dhe Komisionit për Politikë dhe Financa, që të dyja grupet dhanë përgjigje të ngjashme, që kryetarët e komunave dhe drejtorët e njësive të auditimit në përgjithësi thanë që komunikimi në trekëndëshin Drejtor i NjAB-së, Kryetarët Komunë dhe Komitet i Auditimit, funksion shumë mirë, përveç rastit të Prishtinës dhe Pejës, ku ekziston një sistem jo i mirë i komunikimit dhe nevojitet të adresohet si çështje. Komunikimi i Drejtorit të NjAB-së me Komitetin për Politikë dhe Financa bëhet vetëm me kërkesë të këtij komiteti derisa me Kryetarin e Komunës, kërkohet me Ligj.

Në çështjen lidhur me përmirësimet e mundshme në nivelin e komunikimit, 50% e kryetarëve të komunave mendojnë që nuk ka ndonjë hapësirë për përmirësim. Përderisa 30% e Drejtorëve të Njësive të Auditimit të Brendshëm mendojnë njëjtë ndërsa 70% e tyre kanë sygjerruar që ka hapësirë për përmirësime, siç janë takimet e rregullta me Kryetarët e Komunave, Drejtorët e Njësive të Auditimit të Brendshëm dhe Menaxhmentin e mesëm ngase komunikimi horizontal nuk funksionon mirë.

Në pyetjen lidhur me politikën e kallëzimit në rast të shkeljeve, nga grupi i kryetarëve shumica janë

¹³ COSO Korniza e Integruar e Kontrollit të brendshëm

përgjigjur që ekziston komisioni disiplinor. Ndërsa nga grupi tjetër DNjAB thanë që nuk ekziston një politikë e tillë, së paku jo e shkruar. Disa janë përgjigjur që këto çështje i adresojnë te Kryetari i Komunës dhe në disa raste tek Komiteti i Auditimit.

Për një komunë transparente duhet që të vendoset një politikë se si të adresohen rastet e shkeljeve dhe raportimet nga publiku, që nënkupton politikën e kallëzimit. Në përgjithësi ata ju referuan tri elementeve:

1. Raportimi i korrupsionit në Ueb-faqe;
2. Kutia e ankesave;
3. Raportimi direkt tek Kryetari i Komunës.

Përfundim: Kryetarët e Komunave duhet ta kenë të qartë që auditori i brendshëm nuk është aty për të vënë në zbatim asgjë e as për të luajtur rolin e inspektorit, por ka rol të konsultimit dhe këshillimit. Është e qartë që edhe pse nuk është pjesë direkte në zinxhirin e llogaridhënies, auditimi i brendshëm mund të ngritë llogaridhënien në sistemin e vet-qeverisjes lokale duke dhënë rekomandime për përmirësimin e cilësisë së kontrollit të brendshëm, për parandalimin e keqpërdorimit të parasë publike. Këto elemente së bashku do të ngritin transparencën.

Auditorët e brendshëm nuk duhet të shihen ndryshe nga kolegët e tyre përpos pjesë e organizatës, prandaj komunikimi horizontal në këtë pike duhet të jetë i rrjedhshëm. Asnjë organizatë buxhetore nuk mund të ja lejoj vetes mos-komunikimin me zyrën e auditimit të brendshëm dhe çështjet kontradiktore duhet të zgjidhen në këtë pikë.

Mungesa e procedurave të brendshme për trajtimin e çështjeve si politika e brendshme dhe e jashtme e kallëzimit, lejon hapësirë për mos-raportim të shkeljeve, duke qenë se qytetarët/personeli mund të i frikësohen ekspozimit.

Po ashtu është me rëndësi të theksohet që në këtë fazë asnjëri nga respondentët nuk e theksoi ekzistimin e Udhëzuesit Administrativ për transparencë në komuna dhe planet e veprimit që derivojnë si kërkesa nga ky udhëzim, një çështje që po ashtu duhet adresuar.

4. Përmbledhja e përfundimeve të gjeturave dhe rekomandimeve

Me anë të këtij dokumenti kemi përshkruar në hollësi rëndësinë e identifikuar të auditimit të brendshëm në menaxhimin e burimeve lokale. Pa auditimin e brendshëm, nuk mund të ekzistoj një sistem efektiv i kontrollit të brendshëm që do të përmirësoj llogaridhënien dhe menaxhimin efikas të burimeve. Gjithashtu, jemi përpjekur që të identifikojmë dhe paraqesim problemet që ndikojnë në funksionimin efektiv, duke identifikuar disa boshllëqe në nivelin lokal për të kuptuar rolin e vërtet të punës së auditorit të brendshëm. Njëkohësisht, kemi identifikuar që auditorët e brendshëm nuk arrijnë që të kenë ndikim të plotë në përmirësimin e llogaridhënies së përgjithshme në subjektet e nivelit lokal.

Përgjatë raportit, kemi përmendur akter të ndryshëm që janë të përfshirë në funksionimin e auditimit të brendshëm duke treguar që auditimi i brendshëm është pjesë e zinxhirit të llogaridhënies në limitet e kryerjes së vlerësimit të pavarur dhe objektiv të rreziqeve dhe kontrolleve të përcaktuara për të lehtësuar rreziqet. Pritjet janë që auditori i brendshëm të jep këshilla për përmirësimin e veprimeve të përgjithshme në organizatë të cilat pritet të vihen në zbatim nga ana e Menaxhmentit të lartë. Pa dyshim, që nuk është gjithherë në pyetje zbatimin e rekomandimeve por edhe cilësia e punës së auditimit të brendshëm si dhe vlerat etike dhe integriteti i menaxhmentit në adresimin e dobësive në operacione dhe përforsimin e kontrolleve të brendshme. Mirëpo, nëse menaxhmenti veç është dakorduar me raportin përfundimtar të auditimit dhe ka përgatitur planin e veprimit, atëherë ai është zotuar për përmirësime kështu që nëse nuk zbaton rekomandimet për të cilat është dakorduar atëherë nuk ka edhe kontribut të mjaftueshëm të auditorit të brendshëm në zinxhirin e llogaridhënies.

Me qëllim të përmbushjes së obligimit për llogaridhënie, Organizatat buxhetore mund të vendosin kontrollet të ndryshme për të mbrojtur pasuritë e tyre, siguruar pajtueshmëri me të gjithë legjislacionin relevant, politikat dhe objektivat si dhe të sigurojnë që rekomandimet e auditimit të brendshëm po edhe atij të jashtëm merren seriozisht.

Nga rishikimi i dokumentacionit dhe hulumtimit në terren, është vërejtur se korniza ligjore që ndërlidhet me llogaridhënien dhe transparencën, përfshirë themelimin e funksionit të auditimit të brendshëm ekziston deri diku, mirëpo as aq nuk është e zbatuar kënaqshëm në praktikë dhe sygjerimet që rrjedhin nga këto analiza për të përmirësuar zbatimin praktikë janë dhënë në Seksionin e drejtimeve strategjike.

Duke u përpjekur të gjejmë mekanizma që do të venë në veprim akter të ndryshëm ekzistues në mbrojtjen e parasë publike nga keq-përdorimi, humbja dhe mashtrimi, është rishikuar edhe roli i palëve të interesuara në nivel lokal, me përfshirje të organeve të nivelit qendror. Aktualisht kemi Kryetarin e Komunës, Kuvendin Komunal, Auditorin e Brendshëm dhe Komitetin e auditimit, ndërsa puna e Komunës auditohet nga Zyra Kombëtare e Auditimit raportet e të cilës bëhen publike dhe diskutohen nga ana e Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Procesi i auditimit të brendshëm nis me planin strategjik dhe pason me planin vjetor, që përgatitet në konsultim me Kryetarin e komunës dhe miratohet nga ky nivel. Ky dokument pastaj duhet të dërgohet tek Komitetit për Auditim si organ këshillëdhënës. Ky dokument duhet të rishikohet edhe nga Komiteti Komunal për Politikë dhe Financa dhe të vihet në dispozicion për të gjithë të audituarit në organizatë. E njëjta rrugë përshkruhet edhe me produktin final të aktivitetit të auditimit, raportin e auditimit të brendshëm, me një zbrazëtim që KPF nuk pranon rregullisht raportet përfundimtare të auditimit. Për këtë arsye kemi rekomanduar përfshirje më të madhe të këtij komitetit në fazën e përcjelljes së zbatimit të rekomandimeve pasi që ky komitet mund të kërkoj llogari nga Kryetari i Komunës nëpërmes të Kuvendit Komunal. KPF mund të asistohet nga KA në çështjet e natyrës profesionale për të përmirësuar gjendjen e përgjithshme të sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike.

Ky përmirësim do të kontribuonte edhe në transparencën e vetë Komunës, pasi që procesverbalet nga takimet e komiteteve duhet të publikohen dhe njëkohësisht si pjesë e listës së parametrave për transparencë komunale të sygjeruar më poshtë për komuna, këto informata do të ishin në dispozicion publik.

Duke u bazuar në atë që u tha më sipër, sygjerimet për drejtimet strategjike lidhen me përdorimin më të mirë të organeve ekzistuese në kuadër të funksionimit të auditimit të brendshëm, që do të kenë ndikim në përmirësimin e zbatimit të rekomandimeve dhe si rrjedhojë përmirësimin e kontrolleve të brendshëm drejt një qeverisje më efikase në ofrimin e vlerës për parane dhe dhënë dhe përdorimit efikas dhe efektiv të parasë publike në nivel lokal duke qenë më transparente para qytetarit.

	Të gjeturat	Rekomandimet
<p>1. Pozita Organizative e auditimit të brendshëm</p>	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Njësitë e auditimit të brendshëm në komunat e përzgjedhura janë të pozicionuara ashtu që i raportojnë drejt për së drejti Kryetarit të Komunës, me një përjashtim: Komuna e Gjakovës nuk prezanton njësinë e auditimit të brendshëm në organogram fare dhe katër komunat e tjera (Prizreni, Malisheva, Suhareka dhe Gracanica) nuk kanë të publikuar organogramet. Përveç Prishtinës dhe Glllogocit që kanë publikuar organogramet e tyre të tjerat janë ose të vjetruara ose nuk kanë data publikimi. ✓ Statuti i Auditimit të Brendshëm nuk rishikohet periodikisht sa i përketë ndryshimeve. ✓ Njësitë e Auditimit të Brendshëm nuk e kanë personelin e plotësuar siç kërkohet me LAB në shumicën e Komunave. ✓ Drejtorët e NjAB-ve nuk presin që menaxhmenti të 	<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Organogramet e Komunave duhet të publikohen të azhurnuara dhe të paraqesin çfarëdo ndryshimi në Komunë. ⇒ Secila OB duhet të ketë Statut të azhurnuar të Auditimit të Brendshëm i cili publikohet bashkë me dokumentet e tjera të komunës ne ueb faqe. ⇒ Komunitat duhet të zbatojnë LAB për plotësimin e NjAB-ve me numrin e duhur të personelit. ⇒ Menaxhmenti duhet të përkrah auditorët në ndjekjen e trajnimeve shtesë lidhur me profesionin dhe auditorët duhet të planifikojnë trajnimet e tyre gjatë vitit.

	përkrah në ndjekjen e trajnimeve.	
2. Menaxhimi i funksionit të auditimit të brendshëm	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Në përgjithësi nuk ekzistojnë regjistra të rrezikut të përgatitur nga Komuna në të cilët mund të referohet auditori. ✓ Kemi gjetur se jo gjithherë miratohet plani Strategjik dhe ai vjetor. ✓ Jo të gjithë të audituarit informohen me planin strategjik dhe vjetor. ✓ Niveli i kërkesave për auditime të rastit nga menaxhmenti ka shënuar përmirësim në zvogëlimin e tyre. 	<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Menaxherët e lartë të komunës duhet të përgatisin regjistrat e rrezikut për komunën si mjeti më i rëndësishëm në përcjelljen e arritjeve të objektivave të Komunës. ⇒ Planet strategjike dhe si rrjedhojë planet vjetore duhet gjithherë të miratohen nga Kryetari i Komunës dhe Komiteti i Auditimit. ⇒ Të gjithë të auditurit duhet të njoftohen me planet Strategjike dhe Vjetore dhe kjo do të ndihmojë në fazën e takimeve fillestare dhe procesin e mëtutjeshëm. ⇒ Menaxhmenti duhet të i kushtoj kujdes se çfarë planifikohet që të bëjë përpjekje në mbajtjen e nivelit të ulët të kërkesave për auditime të rastit.
3. Ekzekutimi i angazhimit të AB – procesi i auditimit	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Niveli i përgatitjes së planeve të veprimit nga menaxhmenti nuk është në nivel të kënaqshëm. 	<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Menaxhmenti duhet të jetë i vetëdijshëm për llogaridhënien që ka lidhur me përmirësimin e gjendjes në komunat që udhëheqin, andaj duhet të veprojë me përpikëri dhe me kohë në përgatitjen e planeve të veprimit për përmirësimin e përgjithshëm të kontrolleve të brendshme.

<p>4. Ndikimi i aktivitetit të auditimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Kryetarët e komunave nuk janë plotësisht të informuar nëse ekziston apo mirëmbahet rregullit baza e të dhënave për rekomandimet ✓ Procedura ekzistuese çfarëdo që është në raportimin e rekomandimeve të pazbatuara nuk është duke funksionuar si duhet. ✓ Auditorët e brendshëm në nivel të kënaqshëm promovojnë vlerat etike të organizatës. ✓ Auditorët e brendshëm nuk janë duke demonstruar përpjekje të mjaftueshme për minimizimin e dyfishimit të punës së zyrtarëve. 	<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Çdo NjAB duhet të ketë bazën e të dhënave për zbatimin e rekomandimeve që do të azhurnohet rregullisht dhe të njoftojnë me kohë para skadimit të afatit personat përgjegjës për zbatim. ⇒ Duhet të ekzistoj një procedurë e brendshme e shkruar për raportimin e rekomandimeve të pazbatuara ⇒ Auditorët e brendshëm duhet vazhdimisht të rekomandojnë që të minimizohet dyfishimi i punës së zyrtarëve për të siguruar efikasitet, efektivitet dhe ekonomizim të burimeve njerëzore.
<p>5. Transparenca Komunale</p>	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Auditimi i brendshëm nuk kuptohet mjaftueshëm nga kryetarët e komunave; ✓ Kryetarët e komunave nuk presin që auditimi i brendshëm mund t'i ndihmojë ata në llogaridhënie, këtë gjë nuk e konsiderojnë as auditorët e brendshëm; ✓ Komunikimi ekziston vetëm në trekëndëshin 	<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Kryetarët e Komunave të njoftohen për rolin e vërtet të auditimit në llogaridhënie përmes trajnimeve ose formave tjera të informimit si dhe kjo duhet të ofrohet edhe për Drejtorët e departamenteve; ⇒ Auditor i brendshëm ndihmon procesin e llogaridhënies duke sygjerruar rekomandime për përmirësime të vazhdueshme. ⇒ Komunikimi duhet të zgjerohet

	<p>Menaxhment, auditor i brendshëm dhe komitet i auditimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Nuk ekziston ndonjë politikë e kallëzimit për shkeljet, veçmas nga komisioni disiplinor; ✓ E njëjta është valide edhe për politikat e jashtme të Komunës karshi publikut. 	<p>edhe tek akterët e tjerë në komunë si Kuvendi Komunal.</p> <p>⇒ Organizatat buxhetore duhet të bëjnë përpjekje drejt përgatitjes së një politike të kallëzimit sit ë brendshme ashtu edhe të jashtme duke ju referuar specifikave të komunës.</p>
Zyra Kombëtare e Auditimit	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Auditorët e jashtëm nuk mbështetën në punën e auditimit të brendshëm; ✓ Nuk ekziston një komunikim i përcaktuar në mes të auditorëve të brendshëm dhe atyre të jashtëm; ✓ Roli i vërtet i Zyrës Kombëtare të Auditimit nganjëherë nënkuptohet ndryshe. 	<p>⇒ Të bëhen përpjekje që të gjendet bashkëpunim aty ku dyfishohet puna.</p> <p>⇒ Duhet të përcaktohet forma, lloji dhe niveli i komunikimit në mes të auditorëve të brendshëm dhe të jashtëm;</p> <p>⇒ Duhet të ketë një ndërgjegjësim të vazhdueshëm për rolin dhe përgjegjësitë e ZKA.</p>
Komitetet e auditimit	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Marrëdhënia midis Auditorit të brendshëm dhe menaxhmenti konsiderohet në nivel të mirë ✓ Kryesuesi dhe anëtarët e KA nuk janë të trajnuar lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre; ✓ Disa anëtarë të komiteteve të auditimit vijnë nga pozitat që i nënshtrohen auditimit. 	<p>⇒ Duhet të ofrohet trajnim për Kryesuesin dhe anëtarët e KA ekzistues dhe të rijë;</p> <p>⇒ Kryesuesi dhe anëtarët e auditimit duhet të përzgjidhen nga pozita që nuk i nënshtrohen auditimit sepse kjo përbën konflikt interesi.</p> <p>⇒ Marrëdhënia ne mes të KA dhe KPF të vendoset në formën e këshill dhënies;</p> <p>⇒ Pagesa e Kryesuesit dhe anëtarëve</p>

	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Nuk ekziston ndonjë marrëdhënie me mes të këtij komiteti dhe Komitetit për Politikë dhe Financa. ✓ Çështja e pagimit të anëtarëve dhe Kryesuesit të KA pagesave, është e paqartë; ✓ Arsye kryesore në ngecje të zbatimit të rekomandimeve është mos zbatimit i tyre nga ana e menaxhmentit të mesëm; 	<p>të KA duhet të rregullohet me legjislacion sekondar;</p> <p>⇒ Menaxhmentit të mesëm duhet të i kërkohet nga Kryetari i Komunës që të zbatojnë rekomandimet për të cilat ata janë dakorduar për të përmirësuar proceset dhe sistemet në Komunë.</p> <p>⇒ Komitete e auditimit duhet të propozojnë NjAB-ve që të përfshijnë auditim gjysmë vjetor për përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe atij të jashtëm.</p>
--	--	---

5. Drejtimit e ardhshme strategjike

Bazuar në konkluzionet, të gjeturat dhe rekomandimet, në listën e mëposhtme janë prezantuar drejtimit e ardhshme strategjike në një afat më të shkurtë për të cilat nuk kërkohet ndryshim i kornizës ligjore dhe angazhim i burimeve shtesë, si dhe ato në afat më të gjatë ku mund të nevojitet angazhim i akterëve tjerë që nuk kanë qenë subjekt i këtij raporti si dhe ndryshime në kornizën ligjore.

Në një afat më të shkurtë:

Komunat të vënë në zbatim UA ekzistues për transparencë duke hartuar planet ose zbatuar planet e hartuara dhe MAPL të përcjell nivelin e transparencës komunale bazuar në parametrat siç janë sygjeruar në listën e vlerësimit të transparencës;

Kryetarët e komunave të llogarisin më shumë në përkrahjen nga auditorët e brendshëm në procesin e llogaridhënies duke përmirësuar Menaxhimin Financiar dhe kontrollin e brendshëm në bazë të rekomandimeve të AB dhe njëkohësisht të zotohen për përmirësim të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar.

Të ketë përfshirje të vazhdueshme të Komitetit për Politikë dhe Financa në procesin e auditimit dhe bashkëpunimi në mes të KA dhe KPF të intensivkohet.

Kryetarët e Komunave të marrinë për shumë përgjegjësi për zbatimin e rekomandimeve, kështu që të shtyjnë Drejtorët e Departamenteve komunale të zbatojnë përmirësimet e dakorduara si dhe të zbatojnë rekomandimet nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Të ekzistoj një proces i përcjelljes së rekomandimeve dhe mos-zbatimi i tyre të rekomandohet me kohë të Kryetari me shpjegime shtesë.

Zyra kombëtare e auditimit të shoh modalitetet e komunikimit të rregullt me auditorët e brendshëm për të sfidat dhe ndryshimet si dhe për të minimizuar dyfishimin e punës në mes të auditimit të brendshëm dhe jashtëm aty ku ekziston.

Në afat më të gjatë, drejtimi strategjik duhet të fokusohet në:

Ministria e Administratës së Pushtetit Lokale duhet të vendos procesin e përcjellës së rritjet së transparencës nga komunat në çdo tremujor.

Plotësimi i njësive të auditimit të brendshëm me personel të mjaftueshëm për të siguruar edhe cilësinë e punë së auditimit të brendshëm dhe pjesëmarrja e auditorëve të brendshëm në skemat e arsimimit të vazhdueshëm profesional;


Të ofrohen trajnime për Komitetet e auditimit të brendshëm lidhur me obligimet e tyre dhe të qartësohet pagesa e anëtarëve të Komiteteve të auditimit

Të punohet në identifikimin e bazës ligjore për vendosjen e detyrimeve ligjore për Komunitet që të nuk zbatojnë rekomandimet e auditimit të jashtëm, në rast të përsëritjeve vit pas viti. Këto detyrime mund të jenë edhe në formë të sanksionimit me zvogëlim të buxhetit që reflekton përqindjen e parasë publike të humbur ose keqpërdorur;

Zyra Kombëtare e Auditimit të punoj më shumë për promovimin e rolit të saj;

Dhe në fund por jo me më pak rëndësi, duhet të ekzistoj komunikim i cili nuk ekziston i zyrtarizuar në mes të Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrje të Financave Publike.

Zinxhiri i llogaridhënies: Ekzistues dhe ndryshimet e propozuara



- ⇒ Auditori duhet funksionalisht të i raportoj Komiteti të Auditimit;
- ⇒ Auditori i brendshëm administrativisht i raporton Kryetarit të Komunës dhe këshillon Drejtorët e komunës për përmirësimin e efikasiteti dhe efektivitetit të veprimtarive;
- ⇒ Komiteti i Auditimit mund të këshilloj Komitetin për Politikës dhe financa në kuadër të Kuvendit Komunal.

Propozimi i listës së vlerësimit të transparencës në Komuna

Parametrat kryesor në vlerësimin e transparencës

Parametri	Përshkrimi	Arsyetimit
Planet e Buxhetet dhe planet investuese	Ueb faqja duhet të përfshijë buxhetin aktual dhe planet investuese si dhe krahasimet me buxhetet e viteve të kaluara dhe planeve investuese si dhe të paraqes një grafikon se si ka pasur rritje ose zvogëlim gjatë periudhës kohore për të ndihmuar qytetarët në vlerësimin dhe kuptimin e trendëve në shpenzimet e qeverisë lokale.	Buxhetet dhe planet investuese tregojnë pasqyrën complete se cilat janë qëllimet dhe prioritetet që qeveria lokale ka përcaktuar për vitin. Përveç kësaj, të dhënat brenda një buxheti dhe planit investues shërbejë si një mjet krahasues për të përcaktuar se si komuna ka performuar në raport me vitet e kaluara.
Takimet me publikun	Ueb faqja duhet të përfshijë njoftimet për takimet e kryesisë me publikun dhe procesverbalin e takimeve të kaluara. Po ashtu rendin e ditës se takimeve të ardhshme	Takimet janë njëra prej mënyrave të angazhimit në dialog të vërtet me përfaqësuesit. Duke e pasur parasysh realitetin e axhendave të ngjeshura, qeveritarët duhet të ofrojnë takime

ose të kaluara.

alternative

Zyrtarët e përzgjedhur

Ueb faqja duhet të përfshijë emrat e zyrtarëve të përzgjedhur dhe kontaktet e tyre. Po ashtu të dhënat për votimin e një zyrtari të zgjedhur duhet të bëhen publike.

Zyrtarët janë përzgjedhur për të përfaqësuar zgjedhësit e tyre. Për të kryer këtë punë në mënyrë të efektshme, ata duhet të angazhohen në dialog të rregullte dhe të jenë gjithë herë në dispozicion me email, telefon, faks ose postë.

Proceduarat transparente të punësimit

Ueb faqja duhet të përmbajë informata rreth hapjes së vendeve të punës dhe të përfshijë njoftime pasuese që prej publikimit të konkursit deri te përzgjedhja e kandidatit të suksesshëm.

Kjo do të siguronte transparencë lidhur me punësimet në komunë.

Zoonimin dhe lejet e ndërtimit

Më së paku, aplikacionet rreth lejeve të ndërtimit dhe zoonimit duhet të jenë në dispozicion për përdorim online. Po ashtu, qytetarët duhet të mund të përcjellin procesin online.

Gati gjithçka po shkon drejt digjitalizimit. Duke lehtësuar procesin online, komuna mund të zvogëloj shpenzimet dhe kohë si dhe të përmirësoj komunikimin dhe shërbimet për qytetarët e saj.

Auditimet

Uebfaqja duhet të përfshijë informata të rregullta për auditimet, përfshirë edhe raportimin e rezultateve dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve.

Derisa publikimi i buxhetit jep një pasqyrë të përgjithshme, auditimi zbulon se sa mirë performon Komuna në arritjen e synimeve të tyre dhe kjo i mundëson zgjedhësve të saj të kërkojnë llogari.

Takimet

Publikimi i takimeve të ndryshme në nivel komunal:

1. Mbledhja e Kuvendit të Komunës;
2. Mbledhja e Komiteteve
3. Takimet Publike;
4. Takimet Konsultative
5. Takime obligative në media për çështjet që lidhen me shfrytëzimin e buxhetit të komunës.

Nëpërmes të publikimit të takimeve dhe rendit të ditës, publiku mund të ketë qasje në monitorim dhe zbatim të akteve të komunës, përfshirë menaxhimin e financave publike, prokurimit si dhe sferave tjera me interes për publikun.

Prokurimi publik dhe kontratat

Ueb faqja duhet të përmbajë informata rreth procedurave të prokurimit publik në komunë dhe të përfshijë ofertat dhe kontratat për blerje të më shumë se €10,000.

Kjo do të mundësonte informim korrekt dhe proces transparent të prokurimit.

Dokumentet publike

Ueb faqja duhet të përmbajë dokumentet e azhuruara publike

Komuna është e obliguar me ligj që të publikoj dokumentet publike ose të ofrohet qasje nëse një e tillë kërkohet.

Tatimet

Ueb faqja duhet të përfshijë informatat e përgjithshme për tatimet dhe nivelin e grumbullimit të llojeve të ndryshme të tatimeve, ngarkesave dhe tarifave në komunë.

Shpalosja e ngarkimi të tatimit reflekton saktësisht edhe koston e jetesës

Aneks: Lista e Komunave të përfshira në hulumtim

Burimet e përdorura:

- Ligji për vetëqeverisjen lokale;
- Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi;
- Ligji për auditimin e brendshëm;
- Aktet sekondare në përkrahje të zbatimit të këtyre ligjeve;
- Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2015;
- Korniza e Integruara COSO;
- Standardet Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale të Auditimit të Brendshëm, 2016
- Publikime të ndryshme nga Instituti i Auditimit të Brendshëm;
- Transparency International;
- <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2009-159-ang.pdf>
- <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-228%20a.pdf>
- http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2007_02-L133_en.pdf
- <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,159,2615>
- <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,159,4737>
- <http://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11403>
- See the list at the bottom of the document
- USAID and ATRC Project
- The latest version published at: <https://na.theiia.org/standards-guidance/Pages/Standards-and-Guidance-IPPF.aspx>
- The three lines of defence in Effective Risk Management and Control, January 2013;
- The Role of Internal Auditing in the Enterprise-wide Risk Management, January 2009;
- The Role of Internal Auditing in Resourcing the Internal Audit Activity, January 2009
- Kosovo Constitution, Page 13, article 41
- The Corruption Perceptions Index ranks countries/territories based on how corrupt a country's public sector is perceived to be. It is a composite index, drawing on corruption-related data

from expert and business surveys carried out by a variety of independent and reputable institutions.

- <http://www.transparency.org/country/#KOS>
- Scores range from 0 (highly corrupt) to 100 (very clean).
- <http://www.transparency.org/country/#KOS>
- Treasury Financial Rule 01/2010, pg.
- See Law on Self-governance and number date approval
- Professional Practice Framework: International standards for Professional Practice
- Ligji për Buxhetin, për vitin 2015
- COSO Framework
- COSO Internal Control- Integrated Framework. most widely accepted internal control framework.